

NATYRA



Raport



Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor



Agjencia për Mbrojtjen
e Mjedisit të Kosovës

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

GJENDJA E NATYRËS
RAPORT
2008 - 2009

Prishtinë, 2010

Printing of this report was financially supported by United Nation Development Programme (UNDP) and the content of this report is not the responsibility of the UNDP.

Shtypja e këtij raporti është mbështetur financiarisht nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe përmbajtja e këtij raporti nuk është përgjegjësi e UNDP.

“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Të nderuar lexues

Njeriu dhe natyra kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë që nga epokat parahistorike, duke qenë gjithmonë pjesë të pandashme. Breza të tërë të njerëzimit kanë mbijetuar duke i shfrytëzuar të mirat e natyrës dhe duke i përdorur ato në mënyrë të drejtë. Pyjet, kullosat, burimet ujore, kafshët dhe bimët kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Fatkeqësisht, brezi i njeriut të epokës moderne, më shumë se kurrë më parë është duke ndikuar në prishjen e baraspeshës ekologjike të natyrës në planetin tonë. Shkatërrimi i pyjeve, fragmentimi i habitateve, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore janë vetëm disa prej aktiviteteve të njeriut, pasojat e të cilave tani më janë evidente. Si asnjëherë më parë, numri i llojeve që zhduken dhe atyre që kërcënohen për zhdukje është duke marrë përmasa alarmante. Zvogëlimi i resurseve ujore, zgjerimi i thatësisë, katastrofat natyrore, shkrirja e akullnajave polare, janë vetëm disa prej manifestimeve të ndryshimeve klimatike që sot po i ndjejmë në secilën pjesë të globit.

Përkundër faktit se gjeneratat e tanishme kanë nevojë të shumta për t'i plotësuar kërkesat e tyre, është obligim moral që gjeneratave të ardhshme të ju lëmë në trashëgim një natyrë po aq të pasur e të larmishme siç e kemi trashëguar ne nga paraardhësit tanë. Është në ndërgjegjen e njeriut të sotëm të mendoj për të ardhmen e brezave që do vijnë, është në dorën tonë të vendosim për fatin e shumë specieve që kërcënohen për zhdukje. Andaj, është koha e fundit që veprimet tona t'i orientojmë në dobi të natyrës dhe të ardhmes së planetit tonë. Edhe pse mbrojtja e biodiversitetit konsiderohet njëra prej sfidave më të mëdha me të cilat po përballlet njerëzimi sot, ne duhet menduar se çdo qenie e gjallë e këtij globi ka rëndësinë dhe të drejtën për të ekzistuar, ashtu si edhe vetë njeriu.

Kosova edhe pse është një vend i vogël në hartën e globit, karakterizohet me natyrë të pasur, me peizazhe, botë të larmishme bimore dhe shtazore. Edhe vlerat e trashëgimisë sonë natyrore po përballen me presionin e vazhdueshëm nga shfrytëzimi i pakontrolluar dhe i pa planifikuar. Përkundër kësaj, orientimi ynë është që të intensifikojmë përpjekjet për ruajtjen dhe konservimin e këtyre vlerave të rralla natyrore. Duke hartuar politika efikase për mbrojtjen e natyrës, duke rritur sipërfaqet e zonave të mbrojtura, duke ngritur cilësinë e menaxhimit të këtyre zonave, duke mbrojtur llojet e rralla bimore dhe shtazore dhe duke mbrojtur pyjet, ne përmbushim obligimin që gjeneratave pasardhëse t'u japim rastin t'i shijojnë vlerat e rralla natyrore të Kosovës.

Dr. Sc. Ilir Morina,
Kryeshef ekzekutiv i AMMK-së

Përmbajtja

Treguesi i shkurtesave.....	1
Treguesi i tabelave.....	2
Treguesi i figurave.....	2
Hyrje.....	5
1. Historiku i mbrojtjes së natyrës në Kosovë.....	6
2. Qëllimet e mbrojtjes së natyrës.....	7
3. Klasifikimi i Zonave të Mbrojtura.....	8
4. Kronologjia e Zonave të Mbrojtura.....	12
5. Zonat e Mbrojtura të Natyrës.....	15
6. Gjendja e Zonave të Mbrojtura.....	35
7. Biodiversiteti.....	69
8. Iniciativat dhe aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare.....	76
9. Korniza ligjore dhe institucionale.....	81
10. Problemet dhe Rekomandimet.....	86
11. Referencat.....	87

Treguesi i shkurtesave

AKEA	Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
BE	Bashkësia Evropiane
BfN	Agjencia Federale Gjermane për Mbrojtjen e Natyrës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara
DMM	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
DPK	Drejtoria e Parkut Kombëtar
ENVSEC	Nisma për Sigurinë dhe Mjedisin
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (Food and Agriculture Organisation)
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
IUCN	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës
KFOR	Kosovo Force
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
MAB	Man & Biosphere Program
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJQ	Organizata Joqeveritare
PK	Park Kombëtar
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
ProGEO	Shoqata Evropiane për Konservimin e Trashëgimisë Gjeologjike
QEVERIA	Qeveria e Republikës së Kosovës
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Kosovë
UNSECO	Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Treguesi i tabelave

Tabela 1	Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive
Tabela 2	Zonat e Mbrojtura
Tabela 3	Gjendja e kafshëve të egra në Parkun Kombëtar “Mali Sharr” për vitin 2008
Tabela 4	Monumentet e natyrës që janë larguar nga regjistri i zonave të mbrojtura
Tabela 5	Ndërhyrjet ilegale në Zonat e mbrojtura 2008-2009
Tabela 6	Zonat e propozuara për mbrojtje sipas komunave
Tabela 7	Llojet e peshqve të evidentuar në lumenjtë: Drini i Bardhë, Llapi dhe Drenica
Tabela 8	Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës që lidhen me mjedisin
Tabela 8	Projektligjet në procedurë

Treguesi i figurave

Figura 1	Zonat e Mbrojtura të Natyrës në Kosovë (1953 - 1970)
Figura 2	Zonat e Mbrojtura të Natyrës në Kosovë (1976 - 1988)
Figura 3	Zonat e Mbrojtura të Natyrës në Kosovë (2002 - 2008)
Figura 4	Peizazh nga Parku Kombëtar “Mali Sharr”
Figura 5	Bifurkacioni i lumit Nerodime
Figura 6	Pamje nga Rezervati i Rusenicës
Figura 7	Pyjet e rrobullit në Rezervatin në Prevallë
Figura 8	Peizazh nga Rezervati i Oshlakut
Figura 9	Pamje nga Rezervati Pisha e Madhe (majtas) dhe Oshlaku
Figura 10	Pamje nga Gryka e Rugovës
Figura 11	Kristalet në shpellën Gryka e Madhe
Figura 12	Vendburimi termal në Banjë të Istogut
Figura 13	Rrapi (Platanus orientalis) në Marash të Prizrenit
Figura 14	Kompleksi i trunqeve Quercus pubescens në Likoshan
Figura 15	Vaskat në shpellën e Radavcit
Figura 16	Burimi termal në Banjë të Skenderajt
Figura 17	Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajt
Figura 18	Pamje e Ujëvarës së Drinit të Bardhë
Figura 19	Stalaktitet në Shpellën e Gadimes
Figura 20	Ujëvarat dhe liqenet e Mirushës
Figura 21	Zona rekreative e Parkut Gërmia
Figura 22	Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna
Figura 23	Harta e zonimit të PN “Mali Sharr”
Figura 24	Harta e Rezervateve të Natyrës
Figura 25	Dëmtimet e shpellës së Gadimes
Figura 26	Kufiri i shpellës së Gadimes
Figura 27	Hyrja në shpellën e Radavcit
Figura 28	Vaskat në shpellën e Radavcit

- Figura 29 Hyrja në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës
- Figura 30 Pjesë e profilit të shpellës Gryka e Madhe të punuar nga Speleologë Sllovak
- Figura 31 Kristalet nga shpella Gryka e Madhe
- Figura 32 Tabela informuese në Shpellën Gryka e Madhe
- Figura 33 Degradimi i shtratit të lumit Mirusha
- Figura 34 Ndërhyrja në burimin e Drinit të Bardhë
- Figura 35 Thyerja e kristaleve në Shpellën e Ponorcit
- Figura 36 Gjendja e Parkut të Gërmisë
- Figura 37 Monitorimi i zogjve në Ligatinën e Hencit, afër aeroportit të Prishtinës
- Figura 38 Pjesëmarrësit e këtij projekti gjatë trajnimit në Kukës
- Figura 39 Pjesëmarrësit në “GeoTrip 2009” nga ProGEO-Albania dhe ProGEO-Kosova
- Figura 40 Pjesëmarrja në aktivitetet e MAB-it
- Figura 41 Pamje nga shënimi i aktivitetit për ditën e Biodiversitetit

Hyrje

Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor. Zonat më të rëndësishme për biodiversitetin e Kosovës konsiderohen Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku, Koritniku, etj.

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme, janë evidentuar mbi 1800 lloje bimore të florës vaskulare, 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave. Mirëpo, hulumtimi dhe inventarizimi i biodiversitetit akoma nuk ka përfunduar.

Numri i zonave të mbrojtura të natyrës është 97 dhe përfshinë sipërfaqen prej 47.842,34 ha (4.39 % e territorit të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës, 1 Park Kombëtar, 82 Monumente të Natyrës, 2 Parqe Regionale të Natyrës dhe 1 Park Pylli. Në procedim të mëtejshëm kanë mbetur edhe 159 zona të tjera të propozuara, përfshirë këtu edhe territorin e “Bjeshkëve të Nemuna” me sipërfaqe rreth 60.000 ha, për Park Kombëtar.

Gjatë viteve 2008 – 2009 janë zhvilluar edhe disa aktivitete të tjera të rëndësishme për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin. Përgatitja e tri projektligjeve të reja (Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, projektligji për Parkun Kombëtar “Mali Sharr” dhe projektligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”); fillimi i përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2010 – 2020, përgatitja e Planit Hapësinor të PK “Mali Sharr”, zonimi i Parkut Kombëtar “Mali Sharr”, hulumtimi në shpellën “Gryka e Madhe” etj.

Mirëpo, edhe më tutje mbetet shqetësues shfrytëzimi i natyrës pa një kriter të qëndrueshëm, ku në masë të konsiderueshme janë dëmtuar ekosistemet dhe diversiteti biologjik i zonave të mbrojtura. Dëmet më të mëdha i ka pësuar Parku Kombëtar “Mali Sharr” i cili përfshinë 84 % të tërë sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura. Nga këto ndikime nuk janë kursyer edhe zonat e tjera të mbrojtura si: “Shpella e Gadimes”, Parku “Gërmia” dhe “Mirusha”, “Bifurkacioni i Nerodimes” etj.

Raporti për Gjendjen e Natyrës 2008-2009 është përgatitë sipas obligimeve që dalin nga ligji për mbrojtjen e natyrës, i cili në mes të shumë detyrave sipas nenit 2, ka për qëllim: Sigurimin e së drejtës për informim publik dhe pjesëmarrjen e publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;

Në raport përfshihen informacione nga më të ndryshmet, duke filluar nga historiku i mbrojtjes së natyrës, kronologjia e shpalljes së zonave të mbrojtura dhe prezantimi i vlerave natyrore të zonave të mbrojtura dhe të biodiversitetit. Në pjesën kryesore të raportit, paraqitet gjendja aktuale e natyrës, korniza ligjore dhe institucionale si dhe problemet e rekomandimet.

Raporti përmban: 96 faqe të ilustruara me 41 figura dhe 9 tabela, përmes të cilave paraqitet gjendja e vlerave natyrore në terren dhe tendenca në rritje e ndikimit të aktivitetit njerëzor në natyrë.

Për ofrimin e informacioneve gjatë përgatitjes së këtij raporti, falënderojmë: Drejtorinë e Parkut Kombëtar “Mali Sharr”, Inspektoratin e mjedisit të MMPH-së, OJQ “Finch” nga Prizreni, Shoqatën spelologjike “Aragonit” nga Peja, zyrtarët për mjedis të komunave të Kosovës si dhe të gjithë ata që na kanë ndihmuar.

1. HISTORIKU I SHKURTËR I MBROJTJES SË NATYRËS NË KOSOVË

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të '60. Në vitin 1968 formohet njëسيا për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Në vitin 1974 me Vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës themelohet Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ¹, i cili vazhdoi punën me të njëjtin emër sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ². Ndërsa, në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut ³, ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ⁴.

Pas luftës në Kosovë, krijohen rrethana të reja të qeverisjes. Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë i vihet UNMIK-ut në bazë të rregullores 1999/I. Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës" me seli në Prishtinë⁵. Në maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe në kuadër të tij inkorporohen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Mali Sharr".

Pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor⁶ e cila përveç tjerash është përgjegjëse që: "të krijojë politikën, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyrë aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin".

Aktualisht mbrojtja e natyrës realizohet përmes një sektori në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

1 Vendimi për ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyrës ("GZK". 42/74)

2 Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës ("GZK". 15/81)

3 Ligji për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK" 39/88)

4 Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK" nr. 38/89)

5 Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës: nr. i regjistrimit të përkohshëm të subjektit Afarist 80156359, data 14.08.00)

6 Formimi i MMPH-se (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

2. QËLLIMET E MBROJTJES SË NATYRËS

Baza ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe qëllimet e mbrojtjes së natyrës, janë rregulluar me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës .

- Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të përtëritshme të natyrës;
- Rivitalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- Ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- Vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
- Realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
- Zvogëlimin e shfrytëzimit tej mase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre;
- Sigurimin e së drejtës për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
- Sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- Sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes;
- Sjelljen e standardeve të Kosovës në harmoni me ato të Bashkimit Evropian.

3. KLASIFIKIMI I ZONAVE TË MBROJTURA

“Zonë e mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera”⁸.

Kategorizimi i Zonave të Mbrojtura në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është bërë sipas Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës IUCN⁹. Zonat e mbrojtura të natyrës sipas këtij Ligji klasifikohen në 6 kategori:

3.1. REZERVATET STRIKTE NATYRORE

Rezervat strikt i natyrës është territori tokësor ose ujqor që disponon me ekosisteme të shquara me veti gjeologjike dhe lloje, i destinuar para së gjithash për kërkime shkencore dhe monitorim mjedisor.

Rezervatet janë pjesë burimore ose shumë pak të ndryshuara të natyrës, me përbërje vetjake të formave bimore dhe shtazore si dhe bashkësive të tyre, si pjesë të ekosistemeve të parapara para se gjithash për ruajtjen e fondit gjenetik. Rezervatet mund të jenë me rëndësi botanike, ku ruhen në formë “in situ” llojet bimore dhe bashkësitë bimore, ose me rëndësi shtazore për shkak të ruajtjes së llojeve shtazore në vendbanimet burimore të natyrës. Gjithashtu, rezervatet mund të jenë edhe viset në të cilat janë shfaqur një ose më shumë vlera natyrore, të cilat duhet të mbrohen ose dukuri të cilat duhet përcjellë dhe përkujdesur.

Qëllimet e menaxhimit me rezervatet strikte të natyrës janë: ruajtja e habitateve, ekosistemeve dhe llojeve nga shqetësimet, përkujdesja e resurseve gjenetike në gjendje dinamike dhe evolutive, përkujdesja e proceseve ekologjike, ruajtja e vetive strukturore të peizazheve apo relieveve shkëmbore, ruajtja e mostrave të mjedisit natyror për studime shkencore, arsimimi dhe monitorimi mjedisor, ulja e shqetësimeve përmes planifikimit me kujdes të zbatimit të hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera, etj.

Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes dhe ato shpallën nga Qeveria.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura, rezervatet natyrore përfshijnë 847 ha. Në Kosovë deri më tash kemi 3 lloje të rezervateve të mbrojtura: rezervate bimore (7), rezervate shtazore (2) dhe rezervate speciale (2).

⁸ Ligji për mbrojtjen e natyrës 2005/02-L18 (Rreg. nr. 2006/22)

⁹ IUCN është themeluar në vitin 1948 si organizatë e parë globale e mjedisit. Ajo përfshinë brenda vetes më shumë se 1000 organizata anëtare (200 qeveritare dhe 800 joqeveritare) nga 140 shtete të botës. Selinë e ka në Gland, afër Gjenevës, në Zvicër

3.2. PARKU KOMBËTAR

Park Kombëtar është territori natyror i cili shpallet për:

- Mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- Përrjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
- Sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit.

Qëllimet e menaxhimit të Parkut Kombëtar janë:

- Mbrojtja e territoreve natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkom - bëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe turis tike;
- Ruajtja e gjendjes burimore, të shembujve reprezentativ të zonave fiziografike, bashkësive biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve për sigurim-in e biodiversitetit dhe të stabilitetit ekologjik;
- Sigurimi i shfrytëzimit në aspektin inspirues, shkencor, arsimor, kulturor dhe rekreativ që ta mbajë zonën në gjendjen natyrore ose afërsisht naty-rore;
- Përrjashtimi i shfrytëzimeve ose i vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
- Mbajtja e veçorive ekologjike, gjeomorfologjike dhe estetike për të cilat territori është shpallur i mbrojtur.
- Parku Kombëtar shpallet nga Kuvendi i Kosovës.

Në Kosovë deri më sot ekziston vetëm një Park Kombëtar i shpallur nga Kuvendi i Kosovës (1986), “Mali Shar” me sipërfaqe 39 000 ha. Ndërsa në propozim është edhe parku i dytë Kombëtar, Bjeshkët e Nemuna me sipërfaqe të propozuar 62,000 ha.

3.3. MONUMENTET E NATYRËS

Monumenti natyror është territor që përmban një ose më shumë veçori specifike natyrore dhe kulturore, me vlera të posaçme ose unikate, për shkaqe rariteti, vetish natyrore, reprezentative, rekreative dhe estetike ose vlera të posaçme kulturore.

Monumentet natyrore mund të jenë me karakter:

- Gjeologjik (*paleontologjik, mineralogjik, hidrogeologjik, gjeologjik, sedimentet*),
- Gjeomorfologjik (*shpella, humnera, shkëmbinj*);
- Hidrologjik (*ujërrjedha, ujëvara, liqene*);
- Botanik (*ekzemplarët e rrallë të botës bimore*);

Monumentet e natyrës shpallen nga komuna, përveç atyre me rëndësi të posaçme për Kosovën të cilat shpallen nga Qeveria, në propozim të AMMK-së.

Qëllimet e menaxhimit të monumenteve natyrore janë:

- Mbrojtja dhe ruajtja e vetive të qëndrueshme natyrore me rëndësi të posaçme, cilësive unike, dhe vlerave inspiruese;
- Ofrimin e mundësive për kërkime shkencore, arsimore, interpretuese dhe vlerësuese nga publiku;
- Ndalimi dhe pengimi i shfrytëzimeve dhe vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime;
- Ofrimi i beneficioneve aq sa është e lejueshme për popullatën e cila jeton në ato territore, në pajtim me qëllimet menaxhuese.

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës për nga numri zënë vendin e parë me 82, ndërsa për nga sipërfaqja vendin e dytë me 6.296.93 ha.) Prej tyre 55 Monumente Natyrore me karakter botanik, 15 me karakter hidrologjik, 7 me karakter gjeomorfologjik, 4 speleologjik dhe 1 memorial.

3.4. ZONAT E MENAXHIMIT TË HABITATEVE DHE LLOJEVE

Zona e menaxhuar e habitateve dhe llojeve (rezervat natyror i menaxhuar) është zonë tokësore ose ujore që i nënshtrohet intervenimeve aktive për qëllime të menaxhimit për të siguruar përkujdesjen e habitateve dhe plotësimin e kërkesave specifike të llojeve.

Zona e menaxhuar e habitateve dhe llojeve shpallet nga Qeveria e Kosovës. Qëllimet e menaxhimit të zonës së menaxhuar të habitateve dhe llojeve janë:

- Të sigurojë dhe mirëmbajë kushtet e domosdoshme të habitateve për mbrojtjen e llojeve të veçanta, grupeve të llojeve, bashkësive biotike apo veçorive fizike të mjedisit në të cilat kërkohet një veprim i veçantë për menaxhim human;
- Të lehtësojë kërkimet shkencore dhe monitorimin mjedisor, si aktivitete primare të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve;
- Të zhvillojë zonat specifike për arsimim publik dhe vlerësim të karakteristikave të habitateve si dhe për menaxhimin me llojet e egra;
- Të ndalojë dhe parandalojë shfrytëzimin ose uzurpimin që është në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes;
- Të ofrojë beneficione, aq sa është e mundshme, për popullatën që jeton në ato territore, në pajtim me qëllimet e mbrojtjes.

Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes nuk është klasifikuar asnjë zonë e mbrojtur.

3.5. PEIZAZHI I MBROJTUR ME QËLLIM TË RUAJTJES TË PEIZAZHEVE TOKËSORE

Peizazhi i mbrojtur është territor tokësor, ujqor në të cilin bashkëveprimi i njeriut dhe natyrës, për kohë të gjatë, kanë krijuar hapësirë karakteristike, me vlera të theksuara estetike, ekologjike dhe kulturore, e shpeshherë me biodiversitet të theksuar. Ruajtja e integritetit të këtij bashkëveprimi tradicional është esencial për mbrojtjen, përkudjesjen dhe zhvillimin e asaj zone.

Peizazhi i mbrojtur shpallet nga Qeveria e Kosovës. Qëllimet e menaxhimit me peizazhin e mbrojtur janë:

- Mbajtja e stabilitetit në veprimet reciproke të natyrës dhe njeriut me mbrojtjen e peizazheve tokësore, ujore dhe shfrytëzimit tradicional të tokave, ndërtimeve si dhe manifestimeve shoqërore dhe kulturore;
- Përkrahja e mënyrës së jetesës dhe aktiviteteve ekonomike të cilat janë në harmoni me natyrën;
- Ruajtja e larmisë së peizazheve, habitateve të llojeve të ngjashme dhe ekosistemeve;
- Të ndalojë dhe parandalojë shfrytëzimin apo uzurpimin e tokave dhe ndërmarrja e aktiviteteve që nuk janë në pajtim me qëllimet e mbrojtjes;
- Krijimin e mundësive për rekreacion dhe turizëm të cilat i përgjigjen kategorive të zonave;
- Nxitja e aktiviteteve shkencore dhe arsimore për të mirën afatgjatë të popullsisë, si dhe shtimin e mbështetjes publike për mbrojtjen e atyre zonave;
- Ofrimi i beneficioneve dhe kontributit në mirëqenien e komunitetit përmes sigurimit të prodhimeve natyrore siç janë: prodhimet ekologjike të pyllit dhe peshkimi dhe shërbimet tjera si: uji i pastër dhe të ardhurat nga turizmi).

Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë 2 parqet regjionale të natyrës, Parku i Mirushës (555.80.70 ha) dhe Parku i Gërmisë 1126 ha. Parqet Regjionale zënë sipërfaqen prej 1.681 ha, ose 3 % e sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura.

3.6. ZONA E MBROJTUR E RESURSEVE NATYRORE

Zona e mbrojtur e resurseve natyrore është zonë e sistemeve të pandryshuara natyrore, shërben për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e diversitetit biologjik, duke siguruar në të njëjtën kohë prodhimin e produkteve dhe shfrytëzimin e natyrës për t'i përbushur nevojat e shoqërisë.

Në Kosovë nuk kemi asnjë zonë në kuadër të kësaj kategorie.

4. KRONOLOGJIA E ZONAVE TË MBROJTURA

Shpallja e zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë mund të ndahet në tri periudha kohore mjaftë të rëndësishme. Në periudhën initiale të shpalljes së zonave të mbrojtura, në periudhën e intensifikimit më të madh institucional të tyre dhe shpalljen e sipërfaqes më të madhe të zonave të natyrës, duke përfshirë këtu edhe një Park Kombëtar. Si dhe në periudhën e pasluftës, ku janë marrë nën mbrojtje numër i konsideruar i tyre, por edhe është proceduar numri më i madhe i zonave të natyrës në historinë e mbrojtjes së natyrës në Kosovë.

• Periudha 1953 – 1970

Kjo periudhë, ndryshe njihet edhe si faza initiale e mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të para të mbrojtura të natyrës në Kosovë. Ajo fillon me shpalljen e zonës së parë dhe përfshinë aktivitetet deri në krijimin e një institucioni qendror të mbrojtjes së natyrës. Zona e parë është shpallë në vitin 1953, ai ishte “Gazimestani”, Rezervat bimor i bozhures (*Paenonia decora* Anders) në Komunën e Prishtinës.

Në vitin 1955 shpallen edhe 3 rezervate të reja të natyrës. “Maja e Ropsit” (rezervat bimor) dhe “Kozhnjeri” (Rezervat shtazor) në Komunën e Deçanit, si dhe “Rusenica” (Rezervat shtazor) në Komunën e Suharekës.

Në vitin 1960 shpallen edhe 5 rezervate të llojeve bimore natyrore: Gubavci, Maja e Arnenit, Oshlaku, Pisha e madhe, Malet e Prilepit.

Gjatë kësaj periudhe janë vënë nën mbrojtje edhe Shpella e Gadimes si monument i natyrës dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike siç janë: rrapi në Marash, trungjet në Isniq, etj.

Deri në fillimin e viteve të 70 numri i zonave të mbrojtura gradualisht rritej dhe kështu arriti deri në 19 zona.




Fig.1. Zonat e Mbrojtura të natyrës në Kosovë (1953-1970)

• Peridhja 1970 – 1988

Kjo periudhë karakterizohet me shpalljen e numrit më të madh zonave të natyrës. Arsyja e këtij suksesi është themelimi i Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës.

Në fund të viteve të 70 shpallet rezervati “*Bifurkacioni i Lumit Nerodime*” dhe disa monumente të tjera të natyrës me karakter botanik. Vitet e `80 janë vitet më të suksesshme të mbrojtjes së natyrës në Kosovë. Gjatë kësaj kohe janë shpallë Parku i parë Kombëtar “Mali Sharr”(1986), pastaj Parku Regional “Mirusha” (1982), Parku Regional “Gërnia” (1987), Gryka e Rugovës (1985), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983), etj.

Gjatë kësaj periudhe, gjithsej janë vënë nën mbrojtje 32 zona të natyrës.




Fig. 2. Zonat e Mbrojtura të natyrës në Kosovë (1976 - 1988)

• Peridhja 2000 – 2009

Kjo periudhë përket me situatën e pasluftës në Kosovë dhe e karakterizon rithemelimi dhe rifunksionimi i institucioneve të Kosovës. Gjithashtu edhe Institucionet për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit rifillojnë punën. Në këtë kohë rifillon punën edhe ish Enti i Mbrojtjes së Natyrës dhe Ambientit të Kosovës i cili me vonë u emërtua Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë marrë nën mbrojtje ligjore 54 zona të reja të natyrës dhe janë propozuar mbi 159 të tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura shumica janë monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, etj.

Në kuadër të zonave të propozuara është proceduar edhe Parku i dytë Kombëtar, “Bjeshkët e Nemuna” dhe shumë monumente të natyrës.




Fig. 3. Zonat e Mbrojtura të natyrës në Kosovë (2002 - 2008)

5. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS





Fig. 4. Peizazh nga Parku Kombëtar “Mali Sharr”

5.1. PARKU KOMBËTAR “MALI SHARR”

Malet e Sharrit shtrihen në regjionin e Kosovës dhe Maqedonisë (1600 km²). Kosovës i takojnë degët veriore të Sharrit duke përfshirë hapësirën prej 1100 km² që përafërsisht përbën 1/10 e hapësirës së Kosovës. Në vitin 1986 Kuvendi i Kosovës ka shpallë një pjesë të “Maleve të Sharrit” Park Kombëtar me 39.000 ha. Parku shtrihet në kufijtë e katër komunave: Prizren, Therandë, Shtërpcë, dhe Kaçanik.

Malet e Sharrit shquhen për vlera botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive dhe kulturore. Pyjet mbulojnë 48% të sipërfaqe, kullosat 49%, livadhet 1.6%, shkrepat 1.4%. Klima është e shumëllojshme, prej kontinentale e butë deri në klimën alpine në lartësitë mbi 2000 m.

Nga aspekti floristik hyjnë në radhën e maleve më të pasura të Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik dhe paraqesin një thesar të specieve bimore me një numër të madh të llojeve endemike, relikte, të rralla dhe të rrezikuara. Afër 2000 lloje bimore dhe 360 lloje të faunës. Në kuadër të vegetacionit pyjor hasim lloje të ndryshme të dushkut, ahut, bredhit, hormoqit, pishës së bardhë, pishës endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heildreichii*) dhe molika (*Pinus peuce*), lisi i rëndomtë (*Taxus baccata*), çetinaku (*Pinus mugo*), rododendroni (*Rhododendron ferrugineum*) etj. Faunën e Sharrit e përbëjnë: gjarret më të mëdhenj si: ariu i murrmë, kaprolli, dhia e egër, ujku, derri i egër, etj.



Fig. 5. Bifurkacioni i lumit Nerodime

5.2. BIFURKACIONI I LUMIT NERODIME

Bifurkacioni i lumit Nerodime paraqet shembull të vetëm në Evropë, derdhjen e një lumi në dy dete. Lumi buron në Bjeshkët e Jezercit dhe në fshatin Nerodime, ndahet pakthyesëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhët në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore (dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe përmes Vardarit derdhet në Detin Egje. Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për studiues dhe vizitorë dhe ka rëndësi të madhe edukative, shkencore dhe turistike. Që nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës. Sipërfaqja e mbrojtur e rezervatit është 12.78,71 ha.



Fig. 6. Pamje nga Rezervati i Rusenicës

5.3. REZERVATI I RREQEBULLIT NË RUSENICË

Rusenica është vendbanim i rrëqebullit ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), i cili është lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Gjendet në brendi të Parkut Kombëtar “Malet e Sharrit”, në Komunën e Suharekës, dhe është Rezervat i Mbrojtur i Natyrës me sipërfaqe të mbrojtur 300 ha. Rezervati është shpallë në vitin 1955, me qëllim të mbrojtjes së vendbanimit të rrëqebullit.

Rusenica karakterizohet me shkëmbinjtë gëlqerore dhe dy bashkësi pyjore: pyjet e ahut dhe bredhit (*Abieti-Fagetum*) dhe pyjet e ulëta të mëllezës dhe frashrit të zi (*Orno-Ostryio carpinetum*).

Ky lokacion është i rëndësishëm edhe nga aspekti floristik, ku nga llojet e tjera bimë duhet veçuar praninë e llojeve endemike: burnumullera (*Burnmullera dieckii*), panja e maleve (*Acer heldreichii*), etj.



Fig. 7. Peizazh nga Prevalla

5.4. REZERVATI MAJA E ARNENIT

Zona e Rrobullit është e pasur me pyje të llojit endemo - relik të rrobullit (*Pinus heldreichii*), i cili në shpatinat jugore gëlqerore të Oshlakut formon bashkësinë Seslerio-Pinetum heldreichii, ndërsa në shpatiet jug-lindore, që kanë më shumë lagështi, formon bashkësinë *Luzulo maximae* - *Pinetum heldreichii*. Këto bashkësi shtrihen deri në lartësinë mbidetare prej 1946 m. Një pjesë e këtyre pyjeve me sipërfaqe prej 30 ha, në vitin 1960 është shpallur si rezervat strikt i natyrës. Në pjesën lindore të zonës, nën pyjet e rrobullit, gjendet bashkësia pyjore e ahut *Fagetum montanum*.

Zona e pyjeve të rrobullit e propozuar si zonë e I-rë e mbrojtjes (rezervat strikt të natyrës) është e pasur me bimë endemike, nga të cilat veçohen: bar peshku i sharrit (*Vr-bascum scardicum* - st. end.), gencianëza bullgare (*Gentianella bulgarica* var. *Albanica*), karafil i kartusianve (*Dianthus cartusianarum*), karafil shkëmbinjsh (*Dianthus integer*), lulekambane shqiptare (*Campanula albanica*), lisra shqiptare (*Thymus albanus*) etj.



Fig. 8. Peizazh nga Rezervati i Oshlakut

5.5. REZERVATI I OSHLAKUT

Ky rezervat karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike dhe geomorfologjike. Në kuadër të biodiversitetit të pasur të florës veçohen lloje të shumta endemo - relikte dhe fitocenoza të rralla të tyre.

Nga llojet drunore, përveç rrobullit, dredhakut dhe hormoqit të pranishme janë: bredhi (*Abies alba*), arneni (*Pinus peuce*), shelgu i egër (*Salix caprea*), etj. Simboli i veçantë i Oshlakut është lloji lokal endemik i vjetërsisë glaciale *Achillea alexandri regis*, ku me llojin tjetër endemik të Ballkanit qendror *Onobrychis scardica*, formon bashkësinë specifike *Achilleo alexandri regis* - *Onobrychis scardica*.

Nga llojet e tjera të shumta endemike, më të cilët është e pasur zona e Oshlakut veçohen: heliantema e thinjur (*Helianthemum canum*), karafili i sharrit (*Dianthus scardicus*), karafili i gurit (*Dianthus integer*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*) etj. Zona është e pasur me lloje të shumta të shpendëve dhe gjitarëve: pulegra e madhe (*Tetrao urogallus*), thëllëza e gurit (*Alectoris graeca*), pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), etj



Fig. 9. Pamje nga Rezervati Pisha e Madhe dhe Oshlaku

5.6. REZERVATI PISHA E MADHE

Pisha e Madhe karakterizohet me pyjet e vjetra të rrobullit të bashkësisë Seslerio-Pinetum heldreichii, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të rrobullit në Ballkan. Një pjesë e këtyre pyjeve në sipërfaqe prej 35 ha, në vitin 1960 është shpallur si rezervat strikt i natyrës.

Zona është e pasur me lloje të shumta të florës të cilat kryesisht janë kozmopolite (kanë përhapje të gjerë në PK). Vlerë të veçantë kanë lloji endemik *Sedum flexiosum* si dhe llojet me karakter mjekues, siç janë: badhra e bardhë (*Asphodelus albus*), ushojza pa kërcell (*Carlina acaulis*), gencianë e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), bari i ethes (*Centaureum erytrea*) etj.

Pisha e Madhe paraqet habitat edhe për lloje të shumta të kafshëve të egra, ndërsa më të rëndësishme janë: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), macja e egër (*Felis sylvestris*), vjedulla (*Meles meles*), fishnjari (*Martes foina*), skifteri malor (*Falco biarmicus*), shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), etj.



Fig. 10. Pamje nga Gryka e Rugovës (foto Tosi)

5.7. GRYKA E RUGOVËS

Është krijuar nga Lumëbardhi i Pejës. Gryka e Rugovës është gryka më e bukur dhe me atraktive në Kosovë. Gryka e Rugovës është krijuar me punën e erozionit vertikal fluvial, kryesisht në gëlqeroret e triasikut, para dhe pas periudhës glaciale.

Gryka e Rugovës, me 1985 është shpall monument i natyrës me rëndësi hidro-gjeo-morfologjik, me sipërfaqe prej 4.301.05.49 ha. Është një ndër zonat me vlera më të veçanta natyrore. Përveç pasurive në aspektin e florës dhe faunës (biodiversitetit), Gryka e Rugovës, prezanton bukuri të peizazhit, gjeodiversitetit si dhe karakteristika hidrologjike që rrallëkund mund të gjenden.



Fig. 11. Kristalet në shpellën Gryka e Madhe

5.8. SHPELLA GRYKA E MADHE

Ndodhet në kilometrin e tetë (8) të Grykës së Rugovës, në anën e djathtë, rreth 90 m mbi shtratin e Lumëbardhit të Pejës. Gjatësia e korridoreve dhe e galerive të kalueshme është rreth 13.450 m. Kjo shpellë është njëra ndër shpellat më të mëdha në Kosovë dhe region, e krijuar në shkëmbinjtë e Triasikut nga rrjedhja ujore. Në brendësi të shpellës gjenden disa lumenj dhe liqene nëntokësorë të cilët kanë ndikuar në zgjerimin e korridoreve dhe galerive nëntokësore. Në shpellën “Gryka e Madhe”, paraqiten të gjitha llojet e stolive shpellore, por më së shumti ka stalaktite dhe stalagmite të cilat janë prezentë në pjesën më të madhe të shpellës. Shpella “Gryka e Madhe” posedon vlera të rralla natyrore, shkencore, edukativo-arsimore, turistike, dhe është një ndër objektet më të rëndësishëm për realizimin e ekspeditave hulumtuese dhe turistike, jo vetëm në masivin e Bjeshkëve të Nemuna por edhe më gjerë.



Fig. 12. Vendburimi termal në Banjë të Istogut



5.9. BURIMI TERMAL NË BANJË Istog

Në Kosovë gjendet një numër i madh i burimeve minerare, termale dhe termominerare. Mirëpo, pjesa dërmuese e tyre kanë prurje të vogël ujore. Nga burimet termiminerare rëndësi të veçantë ka Banja e Pejës (Ilixha). Burimi ka prurje ujore prej rreth 17.5 l/s dhe temperaturë rreth 49 °C. Sipas përzierjes kimike, uji është kalcium-magnezium-hidrokarbonate. Ndërsa, sipas klasifikimit balneologjik burimi i Banjës së Pejës (Ilixha) bënë pjesë në burime hipertermale. Banja, përveç rëndësisë kurative dallohet edhe si dukuri interesante hidrike me vlera shkencore, estetike dhe edukative.



Fig. 13. Rrapi (*Platanus orientalis*) në Marash të Prizrenit

5.10. TRUNGU I RRAPIT NË MARASH (*Platanus orientalis*)

Ndodhet në bregun e Lumëbardhit të Prizrenit në vendin e quajtur Marash. Është vënë nën mbrojtje ligjore më 1959, me një sipërfaqe prej 0.5 ha. Supozohet se trungu ka vjetërsi mbi 200 vjeçare (sipas gojëdhënave mbi 500 vjeçare). Me dimensionet që ka (lartësia mbi 18 m, diametri i trungut 2.70 m), paraqet një raritet natyror. Duke marrë parasysh ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve të temperaturës, posaçërisht atyre të ulëta, ky lloj tek ne, gjendet vetëm si i kultivuar dhe është mjaftë i rrallë. Njihet po ashtu si njëri prej trungjeve më të vjetra, më dekorativ dhe më karakteristik në Kosovë dhe ka rëndësi shkencore, kulturore, edukative, peizazhore, rekreative dhe ekonomike.



Fig. 14. Kompleksi i trunqeve *Quercus pubescens* në Likoshan

5.11. GJASHTË LISAT E LIKOSHANIT

Kompleksi i trunqeve (*Quercus pubescens*) me vjetërsi dhe strukturë të veçantë është i rrallë në Kosovë. Ky kompleks paraqet vlera natyrore, edukative- arsimore dhe historike për Kosovën. Në vitin 2006 është marrë nën mbrojtje si monument i natyrës me karakter botanik.

Me 28 shkurt 1998, në afërsi të këtyre trunqeve është zhvilluar beteja e parë e UÇK-së.




Fig. 15. Vaskat në shpellën e Radavcit

5.12. SHPELLA E RADAVCIT

Shpella gjendet afër fshatit Radavc, pranë burimit të Drinit të Bardhë, rreth 11- km larg qytetit të Pejës, pranë rrugës Pejë-Rozhajë. Shpella gjendet në pjesën verilindore të vargmaleve të Alpeve Shqiptare (Bjeshkëve të Nemuna). Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe punën kimike të ujërave nëntokësore të Drinit të Bardhë. Gjatësia e korridoreve të kalueshme në shpellën e Radavcit është rreth 1.420m. Kjo shpellë është e pasur me stalaktite, stalagmite, kolona dhe karakteristike kryesore për këtë shpellë janë vaskat. Në brendi të shpellës gjendet një numër i madh i lakuriqëve të cilët nuk janë hulumtuar deri më sot.



Fig. 16. Burimi termal në Banjë të Skenderajt

5.13. BURIMI TERMAL NË BANJË Skenderaj

Burimi termal ndodhet në shpatiet e fshatit Banjë të Komunës së Skenderajt. Burimi ka vlera të rralla hidrike dhe prurje mesatare rreth 15 l/ sec., temperaturë konstante gjatë gjithë vitit (24,8 °C). Këto karakteristika e bëjnë këtë burim me vlera të veçanta. Në vitin 2007 është marrë nën mbrojtje si monument i natyrës më karakter hidrik. Sipërfaqja e mbrojtur është 10 ari.



Fig. 17. Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë



5.14. KANIONI I DRINIT TË BARDHË TË URA E FSHAJTË

Kanioni shtrihet në rrjedhjen e mesme të Drinit të Bardhë. Është fenomen morfohidrik me vlera gjenetike, vizuale dhe edukative. Kanioni është krijuar në periudhën postlakustrike të liqenit neogjen të Dukagjinit. Mirëpo, intensiteti i prerjes dhe thellimit kanionit të epigjjenisë është kushtëzuar dhe nga proceset e lëvizjeve të mëvonshme tektonike. Gryka ka veçori tipike të kanionit dhe është zhvilluar në formacione karbonatike të kretakut të sipërm.

Kanioni i Drinit të Bardhe te Ura e Fshajtë për shkak të vlerave hidro-gjeomorfologjike, në vitin 1986 është marrë nën mbrojtje si Monument Natyror.



Fig. 18. Pamje e Ujëvarës së Drinit të Bardhë

5.15. BURIMI I DRINIT TË BARDHË

Burimi gjendet në pjesën veriore të basenit të Dukagjinit në lartësi mbidetare prej 585 m. Temperatura mesatare e ujit sillet rreth 9 °C. Uji i burimit është i pasur me bikarbonate dhe kalcium - nitrate. Nga burimi i Radavcit krijohen ujëvara më e madhe (25 m) dhe lumi më i madh në Kosovë, Drini i Bardhë. Burimi i Drinit të Bardhë me 1983 është shpallë Monument i Natyrës me rëndësi hidro - morfologjike dhe turistike.



Fig. 19. Stalagtitet në Shpellën e Gadimes

5.16. SHELLA E GADIMES

Gjendet në afërsi të Lypjanit (pranë rrugës Prishtinë – Ferizaj), në fshatin Gadime e ulët. Shpella e Mermertë quhet ngase është e ndërtuar në shkëmbinj të mermerit dhe është një ndër shpellat më të bukura jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan e më gjerë.

Në këtë shpellë paraqiten të gjitha llojet e stolive, stalagmite dhe stalaktite, në forma dhe madhësi të ndryshme, e posaçërisht tërheq vëmendjen stolia aragonite. Shpella është e vjetër me dhjeta miliona vite. Është zbuluar dhe është vënë nën mbrojtje në vitin 1969.



Fig. 20. Ujëvarat dhe liqenet e Mirushës

5.17. KANIONI I MIRUSHËS

Kanioni i Mirushës gjendet në rrjedhjen e poshtme të lumit Mirusha, degë e majtë e lumit Drini i Bardhë. Gryka është krijuar në formacione karbonatike të kretakut të sipërm. Kanioni përveç formave imponante morfologjike shquhet edhe me numër të madh të liqeneve dhe ujëvarave (13 liqene dhe 12 ujëvare) me sipërfaqe, forma dhe lartësi të ndryshme.

Më 1983 pjesa e rrjedhjes së lumit Mirusha me sipërfaqe prej 555,80,70 ha, që përfshinë zonën e Kanionit është shpallur Park Regjional i Natyrës.



Fig. 21. Zona rekreative e Parkut Gërmia

5.18. PARKU REGIONAL “GËRMIA”

Shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës (Prishtinës) dhe përfshinë një sipërfaqe prej 62 km². Në sajë të pozitës gjeografike, pedologjike, kushteve klimatike, masivi malor i Gërmisë është mjaft i pasur si në pikëpamje floristike, vegetative dhe faunistike. Nga hulumtimet e deritanishme janë të evidentuara rreth 600 lloje të florës vaskulare 5 prej të cilave endemike. Po ashtu janë regjistruar 5 lloje ujëtokësorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 19 të gjitarëve dhe rreth 30 lloje të shpendëve.

Për shkak të bukurive të posaçme natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore, të cilat janë me rëndësi kulturore – arsimore, shkencore dhe turistike – rekreative, në vitin 1987, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka marrë nën mbrojtje Kompleksin “Gërmia”, në kategori të Parkut Regional të Natyrës, me sipërfaqe 1.126.01.00 ha.



Fig. 22. Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna

5.19. BJESHKËT E NEMUNA PARK KOMBËTAR I PROPOZUAR

“Bjeshkët e Nemuna” për nga përbërja gjeologjike, geomorfologjike, floristike dhe faunistike paraqesin masivin e rëndësishëm dhe interesant për Kosovën dhe më gjerë. Në Bjeshkët e Nemuna, sipas studimeve, gjenden mbi 1.500 lloje bimore, shumë prej tyre janë lloje relikte si: *Acer heildreichii*, *Asyneuma trichocalicinum*, *Campanula lingulata*, *Cardamine glauca* etj. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme fauna e “Bjeshkëve të Nemuna” përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 148 lloje shpendësh, 36 lloje gjitarësh (pa llogaritur lakuriqët), 129 lloje flutura nga rendi Lepidoptera, etj

Iniciativa për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar ka nisur në vitin 1970 për të vazhduar më pas më 2002. Sipas kësaj iniciative është paraparë që në Parkun Kombëtar të përfshihen pjesë të territorit të Komunës së Pejës, Junikut, Istogut, Deçanit dhe Gjakovës me një sipërfaqe rreth 60.000 ha.

6. GJENDJA E ZONAVETË MBROJTURA



6. GJENDJA E ZONAVE TË MBROJTURA

Gjatë viteve 2008 – 2009 janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin.

- Janë marrë nën mbrojtje 54 zona të reja të natyrës, me ç'rast numri i tyre është rritur në gjithsej 97.
- Për shkak të humbjes së vlerave natyrore, 12 monumente të natyrës janë fshirë nga regjistri qendror i zonave të mbrojtura.
- Janë duke u përgatitur tri projektligje: amadamentimi i projektligjit për Mbrojtjen e Natyrës, projektligji për Parkun Kombëtar “Mali Sharr” dhe projektligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
- Gjatë vitit 2009 ka filluar përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2010 – 2020.
- Është bërë zonimi i Parkut Kombëtar “Mali Sharr” dhe janë propozuar për mbrojtje edhe 10 rezervate të tjera natyrore.
- Është përgatitë drafti i Planit Hapësinor të PK “Mali Sharr” i cili është duke u shqyrtuar nga komunat përkatëse që bëjnë pjesë në kuadër të tij,
- Kanë vazhduar hulumtimet në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës dhe në shpellën e Radavcit, nga speleologët Sllovak, në bashkëpunim me Shoqatën e Speleologeve “Aragoniti” nga Peja dhe ekspertët AMMK. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve dhe e galerive të hulumtuara në shpellën “Gryka e Madhe” është rreth 13 km.
- Nga shfrytëzimi i natyrës pa një kriter të qëndrueshëm, në masë të konsiderueshme janë dëmtuar ekosistemet dhe diversiteti biologjik i zonave të mbrojtura,
- Pasojat më të mëdha të këtij zhvillimi i ka pësuar Parku Kombëtar “Mali Sharr” në të cilën përveç problemeve në menaxhimin e tij, janë evidentuar edhe shumë probleme të tjera siç janë: vazhdimi i ndërtimit të shtëpive në zonën e Prevallës, prerjet ilegale të pyjeve, dëmtimi i pyjeve dhe peizazhit si pasojë e shfrytëzimit të gurit, dëmtimet nga fatkeqësitë natyrore nga era dhe bora, dëmtimet nga insektet dëmtues, nga hedhja e mbeturinave, etj.
- Nga këto ndikime nuk janë kursyer edhe zonat e tjera të mbrojtura si: “Shpella e Gadimes”, Parku “Gërmia” dhe “Mirusha”, “Bifurkacioni i Nerodimes” dhe zonat e tjera.

6.1. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS


Aktualisht numri i zonave të mbrojtura të natyrës është 97 dhe përfshinë sipërfaqen prej 47.842,34 ha (4.39 % e territorit të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: I Rezervate të Natyrës (“Bifurkacioni i lumit Nerodime”, “Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, etj.), I Park Kombëtar (“Mali Sharr”), 82 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë”, “Shpella e Gadimes”, “Gryka e Rugovës”, “Ura e Fshajtë”, shumë biomonumente”, etj.), 2 Parqe Regjionale të Natyrës (“Gërmia” dhe “Mirusha”) dhe I Park Pylli (“Pishat e Deçanit”).

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë Parku Kombëtar “Mali Sharr” me 84 % të sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura.

Tabela 1. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive

Kategoria	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja /ha
I	Rezervate të natyrës	11	846.92
	R.N. Bimore	6	
	R.N. Shtazore	2	
	R.N. Speciale	3	
II	Park Kombëtar	1	39.000
III	Monument Natyre	82	6.296,93
	M.N. Spelologjike	4	
	M.N. Hidrologjike	15	
	M.N. Gjeomorfologjike	7	
	M.N. Botanike	55	
	M.N. Memoriale	1	
V	Pejsazh i mbrojtur	2	1. 683,49
	Park Pylli	1	15
	Totali	97	47.842,34

HARTA E ZONAVE TË MBROJTURA



0 25 50
kilometres

Legjenda

- Monument natyror
- Rezervat natyror
- Park regional

Parku Nacional "Mali Shar"

Tabela 2. Zonat e Mbrojtura

Emërtimi i Zonës	Komuna Viti i mbrojtjes	Sipërfaqja (ha)	Kat.	Përshkrimi i vlerave
REZERVATET E NATYRËS				
1. Maja e Rosit	Deçan 1965	20.00,00	I	Rezervat bimor i llojeve të molikës, breshit, pishës dhe shul
2. Gubecit	Pejë 1969	36.00,00	I	Rezervat bimor i llojit endemo-reikt boshnja (<i>Forsythia europaea</i>)
3. Maja e Arment	Prizren 1960	30.00,00	I	Rezervat bimor me përbërje të pastër të (<i>Pinus heldreichii</i>)
4. Gazimestani	Prishtinë 1963	12.00,00	I	Rezervat bimor i Bozhurës (<i>Paeonia decora Anders</i>)
5. Kozhujeri	Deçan 1955	150.00,00	I	Rezervat shtazor i llojit dhe e egër (<i>Rupicapra rupicapra L.</i>)
6. Oshiku	Prizren 1960	20.00,00	I	Rezervat natyror i armentit (<i>Pinus heldreichii</i>)
7. Malat e Prilepit	Deçan 1963	0.92,00	I	Rezervat bimor i panjës malora (<i>Acer negundo</i>)
8. Rusenica	Therandë 1955	300.00,00	I	Rezervat shtazor i mëqebullit (<i>Lynx lynx L.</i>)
9. Bitunacioni i Lumit Nerodime	Forboj 1979	15.00,00	I	Rezervat special natyror.
10. Pisha e Madhe	Prizren 1960	35.00,00	I	Rezervat bimor i pyjeve të pastër të molikut (<i>Pinus heldreichii</i>)
11. Kamaja	Leposaviq 1988	225.00,00	I	Bregorja gëqerore është Rezervat i veçantë natyror me vlerë paleontologjike.
PARK KOMBETAR				
1. Mali Shar	Prizren, Suharekë, Kapanik, Shtërpoc 1986	39.000	I	Vlera të malla: botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive edukative dhe kulturore
MONUMENTET E NATYRËS				
1. Shpella e Oadmes	Lypjan 1969	36.64,05	II	Gjeom Monument i natyrës i pasur me stol natyror, është ndër shpellat më të bukura në Kosovë dhe më gjera. Ka vlera shkencore, edukative, arsimore dhe turistike
2. Shpella e Baicës	Drenas 1987	00.11,55	III	Gjeom Monument i natyrës me vlera speleologjike
3. Shpella e Glanazellës	Drenas 1987	00.50,17	II	Gjeom Monument me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
4. Gryka e lumit Bistrica	Prizren 1976	200.00,00	II	Monument natyror me karakter hidrologjik dhe peizazhor
5. Burimi i Oritit të Bardhë me Shpellën dhe ujëvarën në Radavc	Pejë 1983	89.94,00	II	Monument natyror me rëndësi gjeomorfologjike, hidrologjike dhe turistike
6. Rrethja e Lumit Mirusha	Therandë, Klinë Mal shëtitës 1983	10.03,35 1.93,94	II	Rëndësi hidrologjike, gjeomorfologjike dhe peizazhor
7. Burimi i ujit mineral në Drenik	Klinë 1985	00.06,75	II	Monument natyror me karakter hidrologjik
8. Burimi termomineral në Vuçë	Leposaviq 1988	16.60,13	II	Monument natyror me karakter hidrologjik
9. Burimi i ujit mineral në Podujevë	Podujevë	00.31,47	II	Monument natyror me karakter

Sallabajtë	1988			hidrologjik.
10. Burimi i ujit në Shajkovc	Podujevë 1988	1.40.54	II	Monument natyror me karakter hidrologjik.
11. Gryka e lumit Kina	Kinë 1985	1.204.94	II	Monument i natyrës me vlera geomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
12. Gryka e Rugovës	Pejë 1985	4.301.05		Rëndësi gjjeologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike dhe botanike
13. Karioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë	Gjakovë, Rahovec 1985	73.88.47 124.05.09	II	Monument natyre me rëndësi hidro-geomorfologjike
14. Krapit (Polaris orientalis) në Marash	Prizren 1959	00.05.00	II	Monument natyre me karakter botanik, edukativ, shkencor dhe kulturor
15. Mani Sham (Morus sp.)	Pejë 1957	00.03.00	II	Monument natyror me karakter botanik
16. Peci (Populus tremula) në Bajçinë	Podujevë 1959	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
17. Biri (Tilia argentea) në Iorio	Degjan 1968	00.02.11	II	Monument natyror me karakter botanike
18. Trungjet e Birit (Tilia argentea) në Iorio	Degjan 1968	00.05.00	II	Monument natyror me vlera të mëlla botanike
19. Trungjet e bungut (Quercus sp.) në Luzicë	Malishevë 1985	00.05.00	II	Monument i rëndësishëm natyror për hulumtime shkencore me karakter botanik
20. Trungu i qamit (Quercus cerna) në Zlakuçan	Kinë 1985	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik dhe turistik
21. Trungu i qamit (Quercus cerna) në Polletë	Podujevë 1983	00.44.20	II	Monument natyror me karakter botanik
22. Trungu i qamit (Quercus cerna) në Dobrinë	Podujevë 1983	00.00.70	II	Monument natyror me karakter botanik
23. Maja e zezë	Pejë 1977	112.50.00	II	Monument memorial i natyrës
24. Mineralet - Kristalet	Stan Tëng, Mitrovicë 1970		II	Mineralet dhe kristalet në ruajtura në Muzeun e kristaleve në Stan Tëng
25. Trungjet e merrjës (Quercus robur) në Nekovc	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
26. Kompleksi i trungjeve të merrjës (Quercus robur) në Negroc	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
27. Trungjet e shpendit në Negroc	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
28. Shpella e Kishnarokës	Drenas 2006	02.00.00	II	Gjeomonument i natyrës me vlera speleologjike
29. Trungu i qamit (Quercus cerna) në Kraqovë	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
30. Guri i Gradinës në Lipushnik	Drenas 2006	02.00.00	II	Monument natyror me karakter geomorfologjik
31. Burimi i ujit Mineral në Poklek	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter hidrologjik
32. Trungjet e dushkut - Gjashtë llast (Quercus sp.) në Likoshan	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
33. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në	Drenas 2006	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik

Tërstenik				
34. Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoshan	Drenas 2008	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
35. Guri i plakës në Dobrosheci	Drenas 2008	00.05,00	III	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
36. Trungu i bungebutës (Quercus pubescens Willd.) në Agarevë	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
37. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Poloc	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
38. Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoc	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
39. Burimi i ujit termal në Banjë	Skenderaj 2007	00.10,00	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
40. Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Prellovc	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
41. Kompleksi i trunjeve të dushkut (Quercus sp.) në Ruzallë	Skenderaj 2007	00.02,00	III	Monument natyror me karakter botanik
42. Kompleksi i trunjeve të bungebutës (Quercus pubescens Willd.) në Klidomirë	Skenderaj 2007	00.10,00	III	Monument natyror me karakter botanik
43. Trungu i qamit (Quercus penis L.) në Kotor	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
44. Trungu i qamit (Quercus penis L.) në Pedaletë	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
45. Trungu i bungebutës (Quercus pubescens Willd.) në Qitak	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
46. Trungu i qamit (Quercus penis L.) në Runk	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
47. Burimi i ujit të njehtë në Lacinë	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
48. Trungu i bungut (Quercus sp.) në Lubovc	Skenderaj 2007	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik
49. Trungu i mënjes (Quercus robur) në Deiq	Klinë 2007	00.03,00	III	Monument natyror me karakter botanik
50. Kompleksi i trunjeve të mënjes (Quercus robur) në Glareve	Klinë 2007	00.28,00	III	Monument natyror me karakter botanik
51. Trungu i qamit (Quercus penis) në Naglavë	Klinë 2007	00.12,05	III	Monument natyror me karakter botanik
52. Burimi i ujit mineral në Rudicë	Klinë 2007	00.07,55	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
53. Trungu i bungut (Quercus pubescens) në Ujëmir	Klinë 2007	00.19,52	III	Monument natyror me karakter botanik
54. Trungjet e dushkut	Suharekë	00.05,00	III	Monument natyror me karakter botanik

(<i>Quercus sp.</i>) në Brashani	2007			
55. Kompleksi i trugjeve të dushkut (<i>Quercus sp.</i>) në Samovë	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter botanik
56. Trugu i pishes (<i>Pinus sp.</i>) në Dolkoc	Suharekë 2007	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
57. Trugjet e dushkut (<i>Quercus sp.</i>) në Greqkoc	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter botanik
58. Trugu i plepit (<i>Populus sp.</i>) në Reçan	Suharekë 2007	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
59. Burimi i ujit mineral në Reçan	Suharekë 2007	00.10.00	II	Monument natyror me karakter hidrologjik
60. Kompleksi i trugjeve të dushkut (<i>Quercus sp.</i>) në Munian	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter botanik
61. Trugu i vodhes (<i>Sorbus domestica L.</i>) në Budakovë	Suharekë 2007	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
62. Kompleksi i trugjeve të dushkut (<i>Quercus sp.</i>) në Papsz	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter botanik
63. Dy trugjet e burgut (<i>Quercus sp.</i>) në Dllacë	Suharekë 2007	00.10.00	II	Monument natyror me karakter botanik
64. Trugu i qanik (<i>Quercus sp.</i>) Vranq	Suharekë 2007	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
65. Lokalesiti i buçent (<i>Quercus trojana</i>) në Drlacë	Suharekë 2007	00.05.00	II	Monument natyror me karakter botanik
66. Kompleksi i trugjeve të burgut (<i>Quercus sp.</i>) në Luzhnicë	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter botanik
67. Guri i Xhamisë në Luzhnicë	Suharekë 2007	00.15.00	II	Monument natyror me karakter geomorfologjik
68. Dy trugjet e mantit të zi (<i>Merus nigra L.</i>) në Carrë	Istog 2008	00.10.53	II	Monument natyror me karakter botanik
69. Trugu i blirit të argjendë (<i>Tilia tomentosa Moench</i>) në Lubozhdë	Istog 2008	00.10.17	II	Monument natyror me karakter botanik
70. Trugu i blirit të kuq (<i>Tilia sp.</i>) në Istog të Pashtim	Istog 2008	00.04.91	II	Monument natyror me karakter botanik
71. Trugjet e bungëbukurës (<i>Quercus pubescens Willd.</i>) në Sinaj	Istog 2008	00.18.71	II	Monument natyror me karakter botanik
72. Trugu i blirit të argjendë (<i>Tilia tomentosa Moench</i>) në Shushicë të Epërme	Istog 2008	00.04.91	II	Monument natyror me karakter botanik
73. Burimi i ujit natyral në	Istog	03.88.19	II	Monument natyror me karakter hidrologjik

Islog	2008			
74. Trugu i vodhës (Sorbus domestica L.) në Ujë	Islog 2008	00.07.07	III	Monument natyror me karakter botanik
75. Trugu i olini të ergeridës (Fila tomentosa Moench) në Kallan	Islog 2008	00.04.91	III	Monument natyror me karakter botanik
76. Burimi i ujit termal në Banjë	Islog 2008	00.05.04	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
77. Trugu i olini të kuq (Tilia sp.) në Lubovë	Islog 2008	00.07.07	III	Monument natyror me karakter botanik
78. Trugu riënjës (Quercus robur L.) në Zallq - Zabllaq	Islog 2008	00.11.33	III	Monument natyror me karakter botanik
79. Trugu riënjës (Quercus robur L.) në Trubuhovë	Islog 2008	00.07.07	III	Monument natyror me karakter botanik
80. Trugu riënjës (Quercus robur L.) në Saradhan	Islog 2008	00.04.15	III	Monument natyror me karakter botanik
81. Trugu i qirit (Quercus robur) në Gurakoc	Islog 2008	00.01.26	III	Monument natyror me karakter botanik
82. Burimi i ujit në Vrellë	Islog 2008	00.28.43	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
PARK REGIONAL				
1. Parku Regional Mruha	Kinë, 1982 Rahovec, 1983 Malishevë,	357.01.72 196.77.98	V	Kanioni me ujëvarat e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike, përfaqësojnë fenomen të rrallë natyror që ka rëndësi natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike
2. Parku Regional Gërnia	Pashinë 1987	1.128.01.00	V	Me rëndësi të madhe shkencore, edukative, kulturore dhe turistike rekreative.
PARK PYLLI				
1. Pishat e Deçanit	Deçan 1988	15.00.00	V	Përbërja e pastër e pishës së zezë të Marasitit i Deçanit

6.2. MENAXHIMI I ZONAVE TË MBROJTURA

Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllim të:

- Kërkimeve shkencore;
- Mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve;
- Ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve;
- Përkujdesjes së shërbimeve mjedisore;
- Mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Turizmit dhe rekreacionit;
- Arsimit dhe sigurimit të qasjes së publikut në informata;
- Përdorimit të qëndrueshëm të resurseve nga ekosistemet natyrore;
- Ruajtjes së veçorive kulturore dhe tradicionale.

Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës definohet me aktet nënligjore në pajtim me ligjet të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori. Sipas Lgjit për Mbrojtjen e Natyrës, për çdo zonë të mbrojtura të natyrës përcaktohet shkalla e I, II dhe III e mbrojtjes.

Akti për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës përcakton qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikat të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i menaxhimit nga organi që e vënë nën mbrojtje dhe i cili aprovohet nga Ministria. Vetëm 3 zona të mbrojtura deri më sot kanë organe menaxhuese.

Menaxhimi me Parkun Kombëtar “Mali Sharr” bëhet nga Drejtoria e Parkut me seli në Prizren që vepron në kuadër të MMPH. Drejtoria për momentin menaxhon territorin e Parkut Kombëtar me sipërfaqe prej 22 230 ha, që gjendet në komunat e Prizrenit (19 500 ha) dhe Suharekës (2 730 ha). **Ndërsa, pjesa e Parkut Kombëtar që i takon komunës së Shtërpçës nuk menaxhohet nga institucionet dhe ligjet e Republikës së Kosovës.**

Rezervatet që gjenden brenda territorit të Parkut Kombëtar: Maja e Arnenit, Pisha e Madhe, Oshlaku dhe Rusenica menaxhohen nga drejtoria e PK “Mali Sharr”, ndërsa rezervatet e tjera (“Maja e Ropsit”, “Gubavci”, “Gazimestani”, “Kozhnjeri”, “Malet e Prilepit”, “Bifurkacioni i lumit Nerodime”, “Kamilja”) nuk kanë organe menaxhuese. Parku Regional “Gërmia” menaxhohet nga ndërmarrja publike “Hortikultura”, ndërsa Parku Regional “Mirusha” nuk ka organ menaxhues. “Shpella e Gadimës” menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje të Qeverisë, ndërsa monumentet tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse.

6.3. GJENDJA E RESURSEVE NATYRORE NË PARKUN KOMBËTAR “MALI SHARR” DHE NË REZERVATET BRENDA PARKUT

Vlerësimi i gjendjes së resurseve natyrore të PK për vitin 2007 - 2008 është bërë në bazë të aktiviteteve (hulumtimeve, monitorimit dhe kontrolleve) të vazhdueshme në terren që janë aplikuar në të gjitha rajonet menaxhuese të Parkut Kombëtar të cilat gjenden në territoret e komunave të Prizrenit dhe Suharekës. Me ç`rast janë analizuar ndikimet dhe pasojat negative të faktorëve biotik (njeriut, insekteve dhe sëmundjeve bimore) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.) në florën dhe faunën si dhe ekosistemet pyjore dhe barishtore të PK.

Gjendja e ekosistemeve pyjore

Gjendja e pyjeve të Parkut Kombëtar, në veçanti të halorëve është e vështirë, si pasojë e ndikimit negativ të faktorëve biotik dhe abiotik. Këta faktorë kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme pyjore. Në disa pyje, në veçanti të rrobullit, ndikimi i këtyre faktorëve rrezikon ekzistencën biologjike të tyre.

Shumica e pyjeve të ahut, të cilët kanë përhapje me të gjerë në Parkun Kombëtar janë në gjendje të mirë, ndërkaq një pjesë e këtyre pyjeve kanë pësuar dëme nga prerjet ilegale dhe fatkeqësitë natyrore.

Dëmi i përgjithshëm pyjor gjatë 2008 nga prerjet ilegale në PK ka qenë 1608.04 m³. Dëmet më të theksuara kanë ndodhur në rajonin e Dellocit, ndërsa në rajonet e tjera menaxhuese të PK ka pasur dëme në vlerë prej 271.3 m³.

Si pasojë e prerjeve masive të pyjeve në këtë rajon të Parkut Kombëtar, Republikës së Kosovës i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme ekologjike, sociale dhe ekonomike (financiare) në vlerë prej 412 356.00 €, nga shuma e përgjithshme e dëmit pyjor prej 498 247.00 €.

Në rajonin e Mushtishtit prerjet më të theksuara janë paraqitur në vendet „Laz” dhe „Guri i Gjatë”, ndërsa në rajonin e Rusenicës si pasojë e shfrytëzimit të gurit nga firma „Vëllezërit e Bashkuar” nga Mushtishti, tërësisht janë dëmtuar pyjet e ulëta në sipërfaqe prej afro 1 ha.

Prerjet ilegale në territorin e Komunës së Prizrenit në krahasim më atë të Suharekës, janë dukshëm më të vogla dhe kryesisht shfaqen në rajonet e Manastrecit, Ljubinjes dhe Prevallës.

Dëmtime sporadike në pyjet e ahut gjatë vitit 2008 janë verifikuar edhe nga fatkeqësia natyrore (era dhe bora), mirëpo intensiteti i tyre nuk ka ndikim të posaçëm negativ në zhvillimin e pyjeve.

Gjendja shëndetësore e pyjeve të rrobullit (*Pinetum heldreichii*) është e keqe, si pasojë e zjarreve pyjore që kanë ndodhur në vitet 2000 dhe 2007, si dhe zhvillimit të madh të insekteve dëmtues (nënlivorësve të pishës *Blastophagus* sp.), që janë shfaqur në mënyrë masive pas zjarreve, si rezultat i dobësimit të imunitetit të drurëve të dëmtuar. Duhet theksuar së në kuadër të pyjeve të dëmtuara gjenden edhe rezervatat strikte natyrore të rrobullit: Maja e Arnenit, Oshlaku dhe Pisha e Madhe të cilët, gjithashtu, kanë pësuar dëme të konsiderueshme pyjore. Pyjet e rrobullit, për shkak të karakterit endemorelikt, paraqesin pyjet më të rëndësishme të Parkut Kombëtar, mirëpo, pikërisht këto pyje janë edhe më të dëmtuara. Drunjtë e thara i janë nënshtruar proceseve të kalbjes dhe thyerjeve që shkaktohen nga erërat e forta malore.

Ripërtëritja natyrore e pyjeve të rrobullit është duke munguar, si pasojë e dëmtimeve të konsiderueshme të pyjeve, dobësimit të vitalitetit të drurëve dhe pranisë së dendur të llojeve barishtore. Gjendja e këtyre pyjeve, duke marrë parasysh intensitetin e madh të tharjes së tyre, mund të vlerësohet si katastrofë natyrore.

Meqë kemi të bëjmë me pyjet endemorelikte të rrobullit, ku masat sanitare në disa zona janë të vonuara, duhet shikuar mundësinë që proceset biologjike t'i lihen natyrës, ndërsa nga masat sanitare të aplikohet vetëm vendosja e feromoneve (kurtheve biologjike) për asgjësimin e nënlivorësve.

Gjendja e vegetacioneve barishtore (kullosave)

Gjendja e kullosave të maleve të larta është e mirë, pasi që shfrytëzimi i tyre dukshëm është zvogëluar pas luftës së 1999, si pasojë e zvogëlimit drastik të numrit të bagëtive në fshatrat përreth territorit të Parkut Kombëtar dhe në regjionin e Prizrenit në përgjithësi. Gjendja e bimëve endemike paraqitet e mirë, mirëpo rigjenerimi është i kufizuar si pasojë e kushteve të vështira klimatike, numrit të vogël të tyre dhe dominimit të llojeve tjera.

Në përkeqësimin e gjendjes së vegetacioneve barishtore në Prevallë, kanë ndikuar edhe parkimi i automjeteve dhe hedhja e mbeturinave nga vizitorët e shumtë, që e vizitojnë këtë vend. Gjatë dy viteve të fundit janë rrezikuar nga degradimi edhe vegetacionet barishtore në rajonin e Gurit të Zi, si pasojë e shtimit të numrit të vizitorëve gjatë verës, në veçanti ditëve të vikendit.

Gjendja e florës

Gjendja e bimëve të rralla barishtore, të cilat i japin vlerë të veçantë florës së Parkut Kombëtar, është e mirë dhe e qëndrueshme. Këto bimë gjenden kryesisht në zonat më të larta (mbi 2000 m) të Parkut Kombëtar dhe janë pjesë përbërëse të kullosave të maleve të larta.

Nga llojet që kanë vlerë të veçantë për Parkun Kombëtar, janë verifikuar në gjendje të mirë këto bimë stenoendemike: barpezmi i mbretit aleksandër (*Achillea alexandris* regis) në Oshlak, bormylera e Dieckit (*Brunmullera dieckii*) në Pashallare, krokusi i

Sharrit (*Crocus scardicus*), karafili i Sharrit (*Dianthus scardicus*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*) në malin Sharr etj.

Disa lloje të rralla të bimëve mjekuese janë objekt i shfrytëzimit ilegal nga njerëz të papërgjegjshëm. Bima më e rrezikuar është sanëza (*Gentiana lutea*) e cila mbledhet nga banorët lokal dhe personat e ndryshëm që e përdorin për tregti (përfitime personale) pasi që ajo ka vlera të veçanta mjekuese. Gjatë vitit 2008 tentimet për mbledhje ilegale të kësaj bime kanë qenë të kufizuara për shkak të shtimit të kontrolleve të terreneve nga Drejtoria e Parkut Kombëtar, në lokacionet ku ajo është e pranishme.

Gjendja e faunës

Gjendja e faunës në Parkun Kombëtar, duke marr parasysh gjendjen ekonomiko-sociale dhe nivelin e vetëdijesimit të popullatës si dhe mungesën e zbatimit të ligjeve, mund të vlerësohet si e mirë. Duhet theksuar se gjendja e kafshëve të egra është përmirësuar pas formimit të Drejtorisë së Parkut Kombëtar në kuadër të MMPH-së, me ç'rast këto resurse natyrore e kanë marrë mbrojtjen më të mirë institucionale. Kjo ka ndikuar në zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të kafshëve të egra, në veçanti të ariut të murrmë, kaproje dhe dhive të egra. Nga gjurmimet e bëra në terren janë verifikuar shumica e kafshëve të egra që janë regjistruar nga hulumtimet e mëhershme, ndërsa shënimet për disa lloje më të rëndësishme që janë të pranishme në territorin e Parkut Kombëtar janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 3: Gjendja e kafshëve të egra në Parkun Kombëtar “Mali Sharr” për vitin 2008

Lloji i kafshës së egër	Gjendja e fondit në fillim të vitit	Reprodukimi vjetor	Humbjet natyrore	Gjendja e fondit në fund të vitit
Ariu i murrmë	22	7	1	28
Kaprolli	40	10	3	47
Rrëqebulli	4	-	-	5
Dhia e egër	170	38	10	198
Derri i egër	50	25	15	60
Lepuri	130	60	40	150
Ujku	9	6	4	11
Shqiponja e përhimë	4	-	-	4
Thëllëza e gurëve	150	50	30	170

Shumica e llojeve të gjitarëve, të cilët kanë qenë të regjistruar në hulumtimet e mëparshme janë verifikuar në terren, mirëpo, për përcaktimin e numrit të tyre nevojiten gjurmimet më intensive në të gjitha rajonet e Parkut Kombëtar. Gjendja shëndetësore e kafshëve të egra është e mirë, ndërkaq rrezik të vazhdueshëm për kafshët e egra paraqet gjuetia ilegale nga njerëz të pandërgjegjshëm. Llojet më të rrezikuara nga gjuetia ilegale janë dhia e egër dhe kaprojtë.

Zonimi i Parkut Kombëtar “Mali Sharr”

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në bashkëpunim me Institutin për Planifikim Hapësinor (IPH) dhe Drejtorinë e Parkut Kombëtar “Mali Sharr” (DPK), në bazë të projektit për zonimin e Parkut Kombëtar për nevojat e hartimit të Planit Hapësinor, gjatë vitit 2008 - 2009 kanë kryer punët profesionale siç janë:

- hulumtimi i vlerave natyrore të Parkut Kombëtar në të gjitha rezervatet ekzistuese dhe ato të propozuara,
- propozimi i zonave të I, II dhe të III të mbrojtjes dhe përcaktimi i kufijve të këtyre zonave,
- përgatitja e hartave dhe raporteve për zonimin e Parkut Kombëtar etj.

Në bazë të vlerave natyrore të verifikuara në terren, ekipi profesional i MMPH ka propozuar, përveç katër rezervateve ekzistuese (**Pisha e Madhe, Oshlaku, Rrobulli dhe Rusenica**), shpalljen edhe të 10 zonave të tjera si zona të kategorisë së I të mbrojtjes, respektivisht si rezervate strikte të natyrës :

- **Kopilica, Dupnica dhe Lumbardhi** në territorin e KK të Prizrenit
- **Bistra, Prrocka e Durlës, Livadhishte dhe Gryka** në territorin e KK Shtëprcë,
- **Pashallare dhe Lendina e Shenjtë** në territorin e KK të Suharekës dhe
- **Luboteni** në territorin e KK të Kaçanikut.

Si zonë e II e mbrojtjes janë propozuar:

- Të gjitha pyjet jashtë rezervateve strikte të natyrës,
- Ekosistemet barishtore që i rrethojnë zonat strikte të natyrës (buffer zona),
- Ekosistemet barishtore që karakterizohen me biodiversitet (shumëllojshmërinë e llojeve bimore) të pasur dhe që gjenden në terrenet e pjerrëta të rrezikuara nga erozionet.

Si zonë e III e mbrojtjes janë propozuar zonat e sipërfaqeve barishtore që janë destinuar për kulllosa, zhvillimin e turizmit, aktivitetet sportive-rekreative dhe ndërtimin e objekteve turistike, si dhe pronat private (livadhet) të komunitetit lokal, që gjenden afër fshatrave që kufizohen me territorin e Parkut Kombëtar.




Fig. 23. Harta e zonimit të PN "Mali Sharr"

6.4. GJENDJA E REZERVATEVE TJERA

Përveç 4 rezervateve që gjenden në brendësi të Parkut Kombëtar “Mali Sharr” (Maja e Arnenit, Rusenica, Koxhaballkani dhe Oshlaku) që përfshijnë një sipërfaqe prej 385 ha ose 45.5 % e sipërfaqes së përgjithshme të rezervateve, ekzistojnë edhe 7 rezervate të tjera. Në territorin e Bjeshkëve të Nemuna janë 4 rezervate: Kozhnjeri, Gubavci, Malet e Prilepit dhe Maja e Robsit me sipërfaqe prej rreth 209 ha ose 24.7 % e sipërfaqes së rezervateve të mbrojtura. Rreth 30 % e sipërfaqes së mbrojtur të rezervateve respektivisht: Bifurkacioni i lumit Nerodime, kodrina e Kamiljes dhe Gazimestani ndodhen jashtë këtyre dy zonave.

Ndikimet negative të faktorit antropogjen si: ndërtimet ilegale dhe ndërhyrjet pa kriter shkencor, prerjet e pakontrolluara por, edhe faktorët tjerë jo antropogjen mbi rezervatet e natyrës në Kosovë si: sëmundjet, zjarret etj. janë ndesh direkt me qëllimet e mbrojtjes, legjislacionin në fuqi dhe normat ndërkombëtare. Ndikime të tilla dhe mungesa e përkujdesjes institucionale e shkencore janë duke bërë që këto rezervate t’i humbin përgjithmonë karakteristikat e tyre natyrore për të cilat janë vënë nën mbrojtje¹⁰.

Një shembull i tillë është Bifurkacioni i lumit Nerodime i cili edhe më tutje nuk është funksional, si pasojë e pengesave të shumta në shtratin e lumit sidomos në degën e majtë.



Fig. 24. Harta e Rezervateve të Natyrës

10 Disa aspekte të kërcënimit të biodiversitetit në rezervatet strikte të natyrës në Kosovë, Instituti Albshkenca Tiranë, 2008

6.5. GJENDJA E MONUMENTEVE TË NATYRËS

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës për nga numri zënë vendin e parë me 82 sosh, ndërsa për nga sipërfaqja vendin e dytë me 6.296,93 ha. Prej tyre 55 Monumente janë të karakterit botanik, 15 hidrologjik, 7 gjeomorfologjik, 4 spleologjik dhe 1 memorial.

Zonat në të cilat ka pas ndikime gjatë këtyre dy viteve janë: Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc, Rrjedha e Lumit Mirusha, etj.

Për shkak të humbjes së vlerave natyrore, 12 monumente të natyrës janë larguar nga regjistri qendror i zonave të mbrojtura.

Tabela. 4. Monumentet e natyrës që janë larguar nga regjistri i zonave të mbrojtura

Nr.	Emërtimi	Komuna	Viti	Kategoria
1	Arneni në Nerodime (<i>Pinus heldreichi</i>)	Ferizaj	1959	monument natyror
2	Bliiri në Strellc të Epërm (<i>Tilia argentea</i>)	Deçan	1961	monument natyror
3	Vidhi fushor në Lukinaj (<i>Ulmus campestris</i>)	Prizren	1981	monument natyror
4	Trungu i qarrit në Potërç të ulët (<i>Quercus sp.</i>)	Klinë	1985	monument natyror
5	Trungu i vidhit në Çabiq (<i>Ulmus minor M.</i>)	Klinë	1985	monument natyror
6	Trungu i qarrit në Bërkovë (<i>Quercus sp.</i>)	Klinë	1985	monument natyror
7	Trungu i qarrit në Dumnicë të P. (<i>Quercus sp.</i>)	Podujevë	1988	monument natyror
8	Trungu i plepit në Orllan (<i>Populus tremula</i>)	Podujevë	1988	monument natyror
9	Çabrati	Gjakovë	1984	monument memorial
10	Rahavane	Therandë	1980	monument memorial
11	Ramjani	Viti	1982	monument memorial
12	Burimi i ujit në Revuqë	Podujevë	1988	monument natyror

• Gjendja e Shpellës së Gadimes

Gjatë viti 2009 me vendim të Qeverisë së Republikës të Kosovës është marrë nën mbrojtje Shpella e Gadimes si Monument i Natyrës me rëndësi të veçantë. Por akoma nuk ka ndonjë rezultat nga zbatimi i këtij vendimi. Gjithashtu gjatë këtij viti është bërë edhe ridefinimi i kufirit të Shpellës së Gadimes dhe është punuar harta. Në Shpellën e Gadimes, edhe më tutje mbeten problemet e njëjta të cilat kanë filluar vite më parë. Veprimet nga jashtë dhe ndikimi i tyre në shpellë siç janë:

- Dukuria e gërryerjes së materialit shkëmbor nga rreshpet,
- Ndërtimi i objekteve në zonën e mbrojtur dhe në afërsi të shpellës,
- Veprimi i guroreve në të cilat eksploatohet guri gëlqeror,

- Ndikimi i minimeve në destabilizimin e shpellës,
- Veprimet e ndryshme në shtratin e lumit Klysyrr përballë shpellës, etj.

Ndërsa në brendësi të Shpellës vërehen probleme serioze siç janë:

- Qarje të mëdha në hyrje dhe në fillim të kanalit të Galerisë të Lotëve.
- Rreziku i shembjes dhe rënies së copave të shkëmbinjve në korridoret që frekuentohen nga vizitorët;
- Ndryshime të dukshme hidrogeologjike, gjë që është manifestuar dukshëm në zvogëlimin e qarkullimit të ujërave nëntokësore.
- Paraqitja e myshqeve dhe kërpudhave si pasojë e ndryshimeve mikroklimatike, të kushtëzuara me mbylljen hermetike të hyrje-daljes si dhe ndriçimi afatgjatë dhe jo adekuat;
- Dëmtimet fizike (thyerje etj.) si dhe larje mekanike të stolive
- Mbishkrimet dhe grafitet nëpër korridoret e shpellës, dëmtojnë imazhin dhe origjinalitetin e shpellës;
- Ndriçimi dhe rrjeti elektrik joadekuat në shpellë është i dëmtuar dhe paraqet rrezik për vizitorë;
- Hulumtimet ilegale të korridoreve të tjera, pa konsultime me institucionet përgjegjëse;
- Menaxhimi joprofesional i shpellës, etj



Fig. 25. Dëmtimet e shpellës së Gadimes



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/57

Data: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 02/L-18 dhe Rregullores Nr. 2006/22), për Mbrojtjen e Natyrës si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Vihet nën mbrojtje "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulet të komunës së Lipjanit, në rrezë të kodrës "Murtur" në kategorinë e monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë.
2. Monumenti i natyrës "Shpella e Gadimes" vihet nën mbrojtje si ndërlikim unikate e specifikave tektonike, gjeologjike, geomorfologjike dhe hidrologjike e formuar në mermer. Vlerë e veçantë a këtij monumenti të natyrës paraqet shfaqja e stolive aragordite.
3. Monumenti i natyrës "Shpella e Gadimes" shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit, Komuna kadastrale Gadime e Ulet dhe përfshin sipërfaqen prej 38.64,95 ha. Në parcelat kadastrale në pronësi shtetërore, nr. 700, 699, 695, 694, 690, 689, 688, 686 dhe 682 me sipërfaqe prej 36.73,21 ha. dhe parcelat kadastrale në pronësi private nr. 697, 695, 693, 692, 691/1 në sipërfaqe prej 1.91,74 ha.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01. nr. 1174-90 ("GZK" nr. 50/82).
5. Vendimi hyr në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim TATI/VE

Kryeministri i Kosovës

Tu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretariatit të Përbashkët të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal Lipjan
- Arkivit të Qeverisë



Fig. 26. Kufiri i Shpellës së Gadimes

Hulumtimi i shpellës së Radavcit dhe “Gryka e Madhe”

Gjatë viteve 2008, 2009 në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës dhe në shpellën e Radavcit, kanë vazhduar hulumtimet nga speleologë Sllovak, në bashkëpunim me Shoqatën e Speleologeve “Aragonit” nga Peja dhe me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Shpella e Radavcit përbëhet prej katër elementeve morfologjike: galeria kryesore, e majtë, e poshtme dhe kanali vertikal. Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të hulumtuara në shpellën e Radavcit është rreth 1420 m, ndërsa kanali horizontal është i gjatë rreth 700 m. Hyrja e shpellës gjendet në lartësinë mbidetare prej 578 m.

Karakteristike për shpellën e Radavcit është kanali me vaska i cili paraqitet në vazhdim të galerisë qendrore. Gjatësia e kanalit të vaskave është rreth 80 m, gjerësia prej 4 - 8 m, ndërsa lartësia në mes të 3-5 m.

Vaskat janë të radhitura dhe në pjesën e poshtme kanë dimensione më të vogla, shpesh janë dyshe e treshe që kanalit i japin pamje të mozaikut. Shumica e vaskave janë pa ujë, ndërsa në disa prej tyre mbesin liqene gjatë tërë vitit.

Pjesa më e madhe e galerive dhe e korridoreve janë të ndotura nga prania e madhe e lakuriqeve dhe nga grafiket dhe mbishkrimet e ndryshme. Dukuri shqetësuese për shpellën e Radavcit është hyrja e personave të papërgjegjshëm në shpellë.



Fig. 27. Hyrja në Shpellën e Radavcit



Fig. 28. Vaskat në shpellën e Radavcit

Hulumtimet në Shpellën “Gryka e Madhe” kanë filluar në maj të vitit 1992, nga disa speleolog Sllovak, edhe pse kjo shpellë ka qenë e njohur nga banorët lokal që prej kohe.



Fig. 29. Hyrja në shpellën “Gryka e Madhe” në Grykë të Rugovës

Në shpellë deri më tani janë hulumtuar pesë nivele. Niveli i parë është niveli i lumit i cili është mjaft aktiv. Ky nivel arrinë lartësinë prej 66 m prej hyrjes nga ku mund të zbritet në shtratin e lumit, përmes disa kanaleve të ngushta në formë të gypave të pjerrtë. Këtu hasim në sedimente apo fundërrina shumëngjyrëshe.

Nivel i dytë shtrihet mesatarisht 15-20 m përmbi rrjedhën aktive të lumit nëntokësor. Pas gjysmë-sifonit të parë, shpella është e dekoruar për mrekulli me të gjitha llojet e mundshme të speleo-dekorimeve si: stalaktite, stalagmite, kolonat, liqene me kristale dhe margaritarë nga kalciti etj.

Karakteristikë tjetër e shpellës janë disa hapësira në të cilat zakonisht ka disa rrjedha të ujit. Këto janë më të rrafshëta, por kalimet në to janë mjaftë të pjerrëta me shumë se 60-shkallë dhe përfundojnë me disa penda-shkëmbinjsh të vogla të mbushura me ujë.

Gjatë ekspeditave (2008 - 2009), është punuar në matjen e korridoreve dhe galerive tjera në shpellë ku është plotësuar harta digjitale e shpellës me përmasa 1:200.¹¹

Hulumtimi i korridoreve dhe i galerive në shpellën Gryka e Madhe dhe në shpellën e Radavcit do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.




Fig. 30. Pjesë e profilit të shpellës Gryka e Madhe të punuar nga speleologët Sllovak



Fig. 31. Kristalet nga shpella Gryka e Madhe



Fig. 32. Tabela informuese në Shpellën Gryka e Madhe

• Rrjedha e Lumit Mirusha

Në rrjedhjen e mesme të lumit Mirusha (zonë e mbrojtur GZK nr. 44/76, 1982), është ndërtuar një pendë me gjatësi rreth 20 m dhe gjerësi 10 m. Ndërtimi i pendës ka ndikuar në degradimin e shtratit dhe të rrjedhjes normale të ujit. Ky akumulacion paraqet shqetësim edhe për banorët vendës, sepse paraqet rrezik nga përmytjet gjatë stinës së pranverës dhe dimrit, kurse gjatë stinës së verës ndikon në shterjen e ujit në shtratin e lumit Mirusha. Për pasojë, në lumin Mirusha janë konstatuar ngordhjet massive të peshqve dhe gjallesave të tjera, e po ashtu kjo ka ndikuar edhe në ujëvarat e lumi Mirusha, duke ndërprerë qarkullimin normal të ujit. (Foto xx).

Ndërtimi i akumulacionit është bërë pa një studim të mirëfilltë hidrogeologjik si dhe pa pëlqim mjedisor.



Fig. 33. Degradimi i shtratit të lumit Mirusha (29.05.2009)

• **Burimi i Drinit të Bardhë**

Në zonën e mbrojtur të burimit të Drinit të Bardhë dhe Shpellës së Radavcit, janë vërejtur ndërhyrje të theksuara në dy lokalitete të zonës së mbrojtur.

- Në vendburimin e Drinit të Bardhë ka pas ndërhyrje nga faktori njeri, është ndërtuar një rezervuar i ujit për hidrocentralin e Radavcit që gjendet nën burimin e Drinit të Bardhë. Kjo ndërhyrje është bërë me beton dhe hekur, e që e dëmton origjinalitetin natyror të këtij monamenti.
- Në afërsi rreth 100 metra nga burimi i Drinit të Bardhë, ka dëmtime të konsiderueshëm të vegjetacionit, prerje të drurëve të shkozës së butë, (*Caprinus betulus*), trungjeve të qarrit (*Quereous puberscens*). Kjo prerje masive e trungjeve ndikon drejtpërsëdrejti në prishjen e peizazhit dhe në paraqitjen e erozionit.



Fig. 34. Ndërhyrja në burimin e Drinit të Bardhë

6.6. GJENDJA E PARQEVË REGJIONALE TË NATYRËS

- **Parku Regjional Mirusha**

Gjatë këtyre dy viteve kanë vazhduar ndërtimet e objekteve të reja hoteliere, ku janë ndërtuar tri restorante. Këto ndërhyrje si dhe dëmtimi i vegjetacionit janë probleme të evidentuara dhe që dëmtojnë vlerat natyrore dhe biodiversitetin e zonës. Por shqetësues është edhe mungesa e një organi menaxhues për Parkun Regjional Mirusha.

Gjithashtu edhe gjendja e trashëgimisë gjeo-morfologjike në pellgun e lumit Mirusha është alarmante. Shpellat edhe pse në numër të konsiderueshëm me vlera të rralla natyrore, shkencore, turistike, historike dhe kulturore pothuajse janë të harruara dhe pa përkujdesje adekuate nga organet komunale, institucionet qendrore. Ato edhe pse janë të evidencuara ende janë të pa hulumtuara, të pa shënjuara, pa status të mbrojtjes, administrim të paqartë dhe të papërcaktuar. Në këto shpella hyjnë në mënyrë ilegale, persona të papërgjegjshëm dhe joprofesional dhe shpesh herë i dëmtojnë kristalet e rralla, interiorin e shpellave dhe hedhin mbeturina¹².



Fig. 35. Thyerja e kristaleve në Shpellën e Ponorcit

12 Bajraktari F. (2009): Trashëgimia natyrore në pellgun e lumit Mirusha (punim masteri) Prishtinë

• Parku Regjional Gërmia

Edhe përkundër mirëmbajtjes së mirë të zonës rekreative nga organizata menaxhuese, janë evidentuar probleme rreth ruajtjes së vlerave në zonat e tjera.

Dëmtime të dukshme gjatë vitit 2008 – 2009 janë shkaktuar në ekosisteme dhe masë drunore përmes eksploatimit të pyjeve dhe nga ndikimi i insekteve (fig. 36, b). Po ashtu janë evidentuar edhe këto ndërhyrje: ndërtimi i fontanës (fig. 36, c), vendosja e antenave në majat më të larta (fig. 36, e) dhe në brendësi të zonës rekreative (fig. 36, a), prezenca e drurëve të thatë dhe zonave të minuara (foto 36, d), mbeturinat në pjesët e thella të parkut etj. Problem mbetet mungesa e planit menaxhues, shenjëzimi dhe zonimi i parkut, etj.



Fig. 36. Gjendja e Parkut të Gërmisë

Tabela 5. Ndërhijet ilegale në zonat e mbrojtura 2008-2009 (Inspektorati i MMPH-së)

Nr.	Zona e Mbrojtur	Komuna	Lloji i aktivitetere	Kategoria
1.	Maja e Arnenit	Prizren	• Antenë e telefonisë mobile	Rezervat natyror
2.	Rusenica	Therandë	• Guri rhyes	Rezervat natyror
3.	Shpella e Gadimes	Lypjan	• Objekt hotelier • Intervenime në brendësi të shpellës	Monument natyror
4.	Bifunkcioni i lumit Nerodime	Ferizaj	• Objekt hotelier	Rezervat natyror
5.	Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit	Pejë	• Objekt hotelier • Hapja e një kanali për HC	Monument natyror
6.	Rrjedhja e lumit Mirushë	Malishevë	• Ponda në shtratin e lumit	Monument natyror
7.	Parku regional Gërmia	Prishtinë	• Objekt hotelier • Antenë e telefonisë mobile • Fontanë • Terrene sportive për fëmijë	Park regional
8.	Gryka e Rugovës	Pejë	• Objekt hotelier	Monument natyror
9.	Parku regional Mirusha	Klinë	• Objekt hotelier	Park regional

6.7. ZONAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJE

Gjatë periudhës 2002 - 2006 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të reja të natyrës në 19 Komuna. Gjatë këtij procesi janë propozuar për mbrojtje mbi 200 zona të reja të kategorive të ndryshme të mbrojtjes, shumica prej tyre monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik etj.

Gjatë viteve 2006-2009, numri i zonave të mbrojtura është rritë ndjeshëm. Prej zonave të propozuara janë marrë nën mbrojtje 58 sish: 11 në Komunën e Drenasit, 13 në Komunën e Skenderajt, 5 në Komunën e Klinës, 14 në Komunën e Suharekës dhe 15 në Komunën e Istogut (Burimit).

Në vitin 2003 ka nisur iniciativa për shpalljen nën mbrojtje edhe të një Parku të dytë Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. IKMN në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe institucionet e tjera, ka përgatitë arsyeshmërinë profesionale. Shpallja e territorit të “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar me sipërfaqe rreth 60.000 ha, është në pritje të miratimit të ligjit. Me marrjen në mbrojtje të kësaj zone dhe zonave të tjera të propozuara, sipërfaqja e mbrojtur në Kosovë do të rritej ndjeshëm.

Në procedim të mëtejme kanë mbetur edhe 159 zona të tjera të propozuara.

Tabela 6. Zonat e propozuara për mbrojtje sipas komunave

Nr.	Komuna	Numri i zonave të propozuara	Viti i njohjes
1.	Gjilan	12	2002
2.	Malishevë	13	2002
3.	Gjakovë	28	2003
4.	Kastriot	6	2003
5.	Vushtrri	17	2003
6.	Rahovec	7	2004
7.	Podujevë	9	2004
8.	Mitrovicë	14	2005
9.	Viti	15	2005
10.	Fushë Kosovë	1	2005
11.	Lipjan	24	2006
12.	Shtime	10	2005
13.	Leposaviq	1	2005
14.	Zveçan	2	2005
	Gjithsej	159	

“Bjeshkët e Nemuna”, Park Kombëtar i propozuar

Iniciativa për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar ka nisur në vitin 1970 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe ka vazhduar përsëri në vitin 1985 nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Sipas kësaj iniciative Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do të përfshinte pjesë të territorit të Komunës së Pejës dhe Deçanit. Meqë Komuna e Deçanit nuk e dha pëlqimin për këtë, u vendos që vetëm pjesa që i takon Komunës së Pejës të shpallej dhe njëherësh u përgatit “Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve në Komunën e Pejës për Park Kombëtar”. Mirëpo edhe kjo iniciativë nuk ka pasur sukses në finalizimin e shpalljes.

Në vitin 2002 Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Natyrës përsëri inicioi shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar. Sipas kësaj iniciative ishte paraparë që në Parkun Kombëtar të përfshihen pjesë të territorit të Komunës së Pejës, Istogut, Deçanit dhe Gjakovës. Kuvendet Komunale përkatëse e kanë dhënë pëlqimin¹³ për këtë nismë .

Në vitin 2003 është përgatitë “Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar dhe njëherësh është përgatitë edhe projektligji për të. Iniciativën e ka përkrahë Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 3.4.2003. Mirëpo më vonë projektligji nuk ka gjet përkrahjen e duhur.

Mirëpo këtë synim Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor e ka edhe më tutje. Në vitin 2009 përsëri e ka formuar grupin punues për hartimin e projektligjit për shpalljen e “Bjeshkëve të Nemuna” Park Kombëtar.

Gjithashtu nuk ka munguar as iniciativa e shoqërisë civile për Bjeshkët e Nemuna. Në Dhjetor 2009 ka filluar projekti “ Bjeshkët e Nemuna- Park Kombëtar, pro et contra”. Projekti mbështetet financiarisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur KFOS dhe implementohet nga Qendra Rajonale Mjedisit- REC zyra në Kosovë.

Një ndër problemet më të mëdha në territorin e “Bjeshkëve të Nemuna” janë prerjet e pakontrolluara të pyjeve që kanë pasoja të pariparueshme e që përveç humbjes së masës drunore, reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemeve, kërcënimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit etj.

Problem tjetër është edhe mungesa e planit hapësinor dhe zhvillimor të zonës, ndërtimi i objekteve hoteliere, etj

Ndërtimet janë më të shprehura në zonat turistike: në Grykën e Rugovës, Bogë, Leqinat etj.

13 KK Pejë- Vendimi nr.352-5339/2002; KK Deçan-01/63, 3 shtator 2002; KK Gjakovë- vendimi 01Nr. 372/2002; KK Istog-Burim- Pëlqimi 01 nr. 41/2002

7. BIODIVERISTETI



Ariu i murrmë (*Ursus arctos*)

Gjatësia: deri në 2m, **peshë:** 150-250 kg.

Përshkrimi: Ariu i murrmë është një nga mishn-grënësit më të mëdhenj dhe më të përhapur në botë.

Statusi: Në përgjithësi, në Evropë konsiderohen të rrezikuar dhe të mbrojtur me ligj. Edhe në Kosovë, ariu i murrme mbrohet me ligj. Popullatat janë kryesisht të vogla dhe gjenden në zona që janë lënë në

gjendjen e tyre të egër, por janë të rrethuara nga zona me veprimtari njerëzore. Si kafshë gjithçkangrënëse, arinjtë e murrmë prirën drejt zonave ku mund të gjejnë ushqime që konsumohen nga njerëzit. Kërcënim për ariun janë gjuetia dhe fragmentimi i habitateve.

Përhapja dhe habitat: Kjo specie është e përhapur në Evropën Veriore, Lindore dhe Juglindore. Në rajon, shpërndarja e ariut të murrmë përkon me shpërndarjen e pyjeve të ahut. Tek ne e hasim përveç në Sharr dhe Bjeshkët e Nemuna edhe në zonat tjera malore të mbuluara me pyje dhe shkurre.

Ushqimi: Dieta e arinjve është shumë e ndryshueshme dhe përmban barëra, erëza, rrënjë, lëna, mana pylli, vezë shpendësh dhe gjitarë, mjalte dhe fruta.

Sjellja: Në përgjithësi, ariu i murrmë lëviz gjatë natës, por ndonjëherë dhe ditën. Megjithëse nuk janë plotësisht letargjike dhe mund të zgjohen lehtësisht, të dy sekset pëlqejnë të futen në një vend të mbrojtur, si shpellë, e çarë apo zgavër gjatë muajve të dimrit. Arinjtë e murrmë janë zakonisht të ndrojtur, por mund të bëhen agresiv në mbrojtje të këlyshëve të tyre.

Riprodhimi: Shumimi ndodh nga maji deri në korrik. Lindin në janar ose në fillim të shkurtit, kur nëna është në gjendje letargjike dhe bën 3 deri në 10 këlyshë.

Zëri: Hingëllimë.



Rrëqebulli (*Lynx lynx*)

Gjatësia: 80-130 cm, **peshë:** 32 kg.

Përshkrimi: Mace e madhe me bisht të shkurtër dhe njolla ngjyrë kafe mbi gëzofin e kuqërremtë. Këlyshët dallohen lehtë nga llojet e maceve të tjera nga xhufkat që kanë tek veshët të cilët i mbajnë të ngritur.

Statusi dhe habitat: Lloji i rrallë dhe në rrezik zhdukjeje. Nën-popullatat e vogla, të mbetura në Evropën Qendrore, janë të izoluara dhe vuajnë nga fragmentimi i habitateve. Në Kosovë gëzon statusin e mbrojtjes ligjore si lloji i rrallë dhe i rrezikuar.

Përhapja dhe habitat: Në Evropën Qendrore, speciet mbijetojnë vetëm në disa rajone. Një nga rajonet e Evropës Qendrore që shquhet me prezencën e këtij lloji është pjesa e maleve Dinarike në Kosovë (Rezervati i Rusenicës në PK "Mali Sharr"), Shqipëri, Republikën e Maqedonisë dhe Greqi. Rrëqebulli i Ballkanit, ka një popullatë shumë të vogël me më pak se 100 individë. Në territorin e PK "Mali Sharr" gjendet rezervati strikt i Rusenicës, ku haset ky lloji i rrallë.

Sjellja: Në përgjithësi lëviz natën dhe në vetmi. Kur ushqimi është i pamjaftueshëm, e kërkon në sipërfaqe me një rreze deri në 30 km. Nuk emigron dhe nuk bie në letargji.

Ushqimi: Rrëqebulli ushqehet me kafshë thundrake, gjitarë të tjerë, por edhe me shpendë të cilët i mbytet me një kafshim në fyt.

Riprodhimi: Shumohet një here në vit, në fillim të pranverës. Bën 1-4 këlyshë të verbër dhe të mbuluar me qime, të cilët maturohen në vitin e dytë.

Zëri: Dëgjohej rrallë. Gërmimë maceje dhe hungërimë.



Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*)

Gjatësia: 1.1-1.8 m, pesha: 35-50 kg.

Përshkrimi: Është banor i zakonshëm i kullotave të zonave të larta të rajonit i gjendur në koloni të izoluar. Të rriturit e këtij gjatari që ngjan me dhinë kanë dy brirë të shkurtra, fytyrë ngjyrë të bardhë me dy vija të zeza. Në verë gëzofi është ngjyre gri e hapur dhe në dimër bëhet thujse i zi.

Statusi: Popullata e dhive të egra është e vogël dhe e kërcënuar nga konsumi për mish, si nga njerëzit dhe nga qentë, fragmentimi i habitatit dhe aktivitetet turistike. Tek ne gëzon status mbrojtjeje ligjore si lloj i rrallë dhe i rrezikuar.

Përhapja dhe habitat: E përhapur në Evropë. Nënllloji i Ballkanit (*Rupicapra rupicapra balcanica*) jeton në shumicën e rajoneve malore të Kosovës e kryesisht në Malet e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna (Rezervati i Kozhnjerit). Popullatat kanë disa qindra individë. Jetojnë në masivet malore, rrëpira, shkëmbinj dhe pyje, por edhe në kullotat alpine, pyjet e përziera dhe zonat e mbjella me peme halore.

Ushqimi: Në përgjithësi ha gjethe, bar, fruta, etj.

Sjellja: Dhite e egra janë të shoqërueshme, jetojnë në tufa të vogla në verë dhe bashkohen në tufa me mbi 100 krerë në dimër. Femrat dhe të vegjlit gjenden në tufa me nga 5-30 kafshe, ndërsa meshkujt e rritur priren të qëndrojnë të vetmuar në pjesën më të madhe të vitit. Dhia e egër nuk migron dhe nuk bie në letargji.

Riprodhimi: Shumohet një here në vit, në pranverë. Bën 3-12 keca që zhvillohen shpejt dhe ndjekin dhinë e rritur. Maturohen në vitin e dytë ose të tretë dhe mund të jetojnë deri 20 vjet.

Zëri: Hungërimë dhe klithma të ngjashme me dhinë e butë.



Shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*)

Gjatësia: 76-89 cm, **krahët e hapur:** 190-227 cm.

Përshkrimi: Shpend mishngrënës shumë i njohur që ndeshet rëndom në zonat malore të rajonit. Ka aftësi të mëdha fluturuese dhe shpejtësi të madhe manovrimi. Dallohet lehtë edhe në distanca të largëta falë qafës dhe bishtit të gjatë dhe të gjerë si dhe gjatësisë së krahëve. Të rriturit kane pupla të



verdha në qafë dhe në kokë dhe janë krejtësisht ngjyrë kafe, me shirita të zbehtë në pjesën e sipërme të krahëve. Të vegjlit kanë njolla të bardha në krahë dhe në bazën e bishtit, çka i bën lehtësisht të dallueshëm nga të rriturit.

Përhapja dhe habitat: Parapëlqejnë mjediset malore dhe shkëmbinjtë. Tek ne e hasim në Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.

Riprodhimi: Riprodhohet në shkëmbinj dhe në pemë të mëdha. Femra pjell dy veze, me pulla kafe në të kuqe. Folenizimi nis në prill dhe ngrohja e vezëve zgjat afro gjashtë javë. Shpesh vetëm një nga të vegjlit u mbijeton 11 javëve të para, dhe arrin të rritet plotësisht.

Ushqimi: Përbehet kryesisht nga lepuj dhe thëllëza, por edhe nga bagëti të ngordhura, gjitarë të vegjël dhe kërmja.

Zëri: Në trajtën e kuisjeve "kjek-jek-kjek...".

Gjeli i egër (*Tetrao urogallus*)

Gjatësia: 60-87 cm, **krahët e hapur:** 87-125 cm.

Përshkrimi: Janë shpendë shumë të mëdhenj. Ngjiten në fluturim me zhurmë shumë të fortë të krahëve. Fluturimet janë të shkurta, të shpejta dhe në vijë të drejtë. Gjeli i egër është i famshëm për sjelljen e mahnitshme flirtuese të meshkujve, qafën e gjatë që e mban drejt dhe bishtin e ngritur kur krekoset. Mashkulli ka sqep të rëndë, të përkulur, me ngjyrë të verdhë. Femrat janë ngjyrë kafe me vija të zeza në krahavor.



Përhapja dhe habitat: Jetojnë tek ne në pyje halore ose të përzier, zona me pisha të vjetra në vende shkëmbore si në Sharr dhe Bjeshkë të Nemuna. Në fund të pranverës zbresin në livadhe ku meshkujt bëjnë paradat flirtuese.

Riprodhim: Folenizimi nis nga fundi i prillit. Femra lëshon 7-11 vezë, inkubacioni zgjat 24 - 26 ditë dhe të vegjlit janë të aftë për fluturime të shkurtra kur mbushin moshën 2-3 javore. Janë të aftë të fluturojnë plotësisht pas 2-3 muajsh.

Ushqimi: Hanë hala pise dhe bredhi, gjethe dhe gonxhe lulesh.

Zëri: Në mbrëmje dëgjohet kënga "ko-krekkorok". Meshkujt kanë një kakarisje të ngadaltë e të përsëritur "grak". E gjithë kënga zgjat 5-7 sekonda dhe mund të dëgjohet deri në 200-300 m largësi.

Lejleku (*Ciconia ciconia*)

Gjatësia: 100 - 115 cm, **krahët e hapur:** 195 - 215 cm.

Përshkrimi: Dallohet qartësisht nga llojet e tjera të familjes së çafkave për shkak të trupit me ngjyrë të bardhë, bordurën e zezë të krahëve, sqepin dhe këmbët e kuqe. Në fluturim është i madhërishtëm me gishtërinjtë e dukshëm. Krahavori i bardhë.



Parapëlqen fluturimin rrafsh dhe shfrytëzon më së miri rrymat e ngrohta ajrore.

Përhapja dhe habitat: Shpend folenizues tepër i zakonshëm deri në vitet 50 – 60, sidomos në ultësira. Haset shpesh në toka bujqësore dhe kënetore. Vrojtohet në grupe të vogla gjatë shtegtitimit vjeshtor.

Riprodhimi: Në Kosovë ende nuk dihet sakt numri i foleve të lejlekut. Fole të ndërton në maje të objekteve të larta si pemë apo shtylla tensioni. Fole të janë të stërmëdha të përbëra nga njëthurje shkopinjsh. Lëshojnë 3-5 vezë të bardha që çelin pas 33-34 ditësh. Të vegjlit arrijnë fluturimin pas 56-64 ditësh.

Ushqimi: Përbëhet kryesisht nga kafshë të vogla si bretkosa, gjarpërinj, peshq, brejtës të vegjël, krimba, shpend të vegjël, etj

Zëri: Zakonisht i heshtur, me përplasje të forta të sqepit, sidomos kur partnerët takojnë njëri – tjetrin në fole.

7.1. GJENDJA E BIODIVERSITETIT

Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor.

Gjendja e florës dhe vegjetacionit

Zonat më të rëndësishme për florën e Kosovës konsiderohen Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku, Koritniku, etj

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme floristike janë evidentuar mbi 1800 lloje bimë të florës vaskulare, megjithëse supozohet se numri i tyre është më i madh (rreth 2.500). Në kuadër të llojeve të hulumtuara rreth 200 prej tyre janë endemike, endemorelikte dhe subendemike. Sidomos është i rëndësishëm grupi i endemikëve lokal, numri i të cilëve është ende i pa definuar plotësisht, disa prej të cilave kanë përhapje mjaft të kufizuar.

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shekuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim është jo racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasojë të paparashikueshme. Dëme të mëdha po i shkaktohen florës së bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale, nga grumbulluesit e tyre.

Gjendja e faunës

Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe të llojeve edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Hapësirat më të begatshme faunistike në Kosovë janë të gjitha masivet malore të Kosovës, por vlen të veçohen: Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Llogaritet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave.

Hulumtimet e peshqve

Me gjithë rrjetin e pasur të lumenjve Kosova ende nuk ka një inventar të plotë për llojet e peshqve, për shkak të mungesës së hulumtimeve ihtiofaunistike. Deri më sot janë të hulumtuara disa nga lumenjtë e Kosovës dhe janë evidentuar gjithsej 30 lloje të peshqve. Prej tyre në lumin Drini i Bardhë janë të njohura 18 lloje¹⁴, në lumin Llap 12 lloje¹⁵ dhe në lumin Drenica 17 lloje të peshqve.¹⁶

14 Grapci – Kotori, L. (2006) Ndikimi i faktorëve ekologjik në dinamikën e popullatave të llojeve të peshqve në lumin Drini i Bardhë, disertacion i doktoraturës, UP-FSHMN, Prishtinë

15 Gashi, A. (2006) Analiza biocenologjike dhe ekologjike e makrozoobentosit dhe nehtonit të lumit Llap, disertacion i doktoraturës, UP-FSHMN, Prishtinë

16 Maxhuni, Q. (2009) Uticaj ekoloških faktora na dinamiku populacija riba rijeke Drenice, magistarski rad, US – PMF, Sarajevo

Tabela 7. Llojet e peshqve të evidentuar në lumenjtë: Drini i Bardhë, Llap dhe Drenica

Emri i llojit	Emërtimi shqip	Drini i bardhë	Llap	Drenicë
1. <i>Salmo trutta</i> m. <i>Fario</i>	<i>Trofta</i>	+	+	
2. <i>Oncorhynchus mykiss</i>	<i>Trofta e Kalifornisë</i>	+		
3. <i>Salmo marmoratus</i>	<i>Trofta e mermertë</i>	+		
4. <i>Leuciscus leuciscus</i>	<i>Mlyshi i vogël</i>	+		
5. <i>Barbus barbus</i>	<i>Mustaku</i>	+	+	
6. <i>Ctenopharyngodon idella</i>	<i>Amuri i bardhë</i>	+		
7. <i>Squalius cephalus</i>	<i>Mlyshi</i>	+	+	+
8. <i>Leucaspis delineatus</i>	<i>Gjuca</i>	+	+	+
9. <i>Gobio gobio</i>	<i>Barburiqi</i>		+	
10. <i>Gobio obtusirostris</i>	<i>Barbuqi</i>	+		+
11. <i>Stizostedion lucioperca</i>	<i>Luciperku</i>	+		
12. <i>Anguilla anguilla</i>	<i>Ngjala</i>	+		
13. <i>Cottus gobio</i>	<i>Peshku kinez</i>	+		
14. <i>Rutilus rutilus</i>	<i>Sykuqi</i>			+
15. <i>Alburnoides bipunctatus</i>	<i>Barkëgjëri</i>			+
16. <i>Barbus balcanicus</i>	<i>Mërena</i>			+
17. <i>Phoxinus phoxinus</i>	<i>Skorti i pëllgjeve</i>			+
18. <i>Rhodeus amarus</i>	<i>Hidhtaku</i>			+
19. <i>Carassius gibelio</i>	<i>Karashi</i>	+	+	+
20. <i>Chondrostoma nasus</i>	<i>Njila</i>	+	+	+
21. <i>Cyprinus carpio</i>	<i>Krapi i egër</i>	+	+	+
22. <i>Alburnus alburnus</i>	<i>Gjuca</i>			+
23. <i>Scardinius erythrophthalmus</i>	<i>Lloska</i>	+	+	+
24. <i>Cobitis elongatoides</i>	<i>Mërena e egër</i>			+
25. <i>Barbatula barbatula</i>	<i>Tufëza</i>			+
26. <i>Silurus glanis</i>	<i>Siluri</i>			+
27. <i>Perca fluviatilis</i>	<i>Sharroku</i>	+	+	+
28. <i>Tinca tinca</i>	<i>Lina</i>		+	
29. <i>Vimba vimba</i>			+	
30. <i>Misgurnus fossilis</i>	<i>Guvori</i>	+		

- **Biodiversiteti i ligatinës së Hencit ¹⁷**

Gjatë vitit 2008 – 2009 është hulumtuar Ligatina e parë në Kosovë. Ajo është Ligatina e Hencit me sipërfaqe mbi 70 ha, e cila është krijuar në mënyrë artificiale në fund të viteve të 60-ta të shekullit të kaluar për qëllim të kultivimit të krapit. Për shkak të suksesioneve natyrore përgjatë rreth 40 viteve ajo ka marrë karakterin e plotë të një ligatine dhe sot është biotop i përshtatshëm për shumë lloje bimore dhe shtazore. Aty janë identifikuar 19 lloje të bimëve vaskulare, ndërsa nga bota shtazore: 4 lloje të peshqve, 2 lloje të amfibeve, 3 lloje të reptilëve, 41 lloje të shpendëve, 2 lloje të gjitarëve dhe 8 lloje të fluturave nga rendi odonata. Ky numër llogaritet të jetë edhe më i madh. Për arsye të ruajtjes së këtij biodiversiteti të pasur, ligatina duhet të shpallet si zonë ligatinore e mbrojtur dhe njëherazi mund të propozohet si Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) për Kosovën. Kjo do të bënte të mundur ruajtjen dhe menaxhimin e saj të qëndrueshëm sipas kërkesave të konventës RAMSAR. Menaxhimi i qëndrueshëm i kësaj zone mund të ofrojë mundësinë edhe për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative siç është vrojtimi i shpendëve, peshkimi, çlodhja që mund të ofrojë kënaqësi për shumë vizitorë dhe mund të sjellë përfitime të ndryshme ekonomike.

Fig.37. Ligatina në Henc



- **Aktivitetet në kuadër të projektit për Gripin e Shpendëve në bashkëpunim me zyrtarët e Agjencionit të Veterinës dhe të Ushqimit si dhe atyre nga FAO**

Gjatë vitit 2008-2009 në kuadër të projektit për Gripin e Shpendëve në bashkëpunim me zyrtarët e Agjencionit të Veterinës dhe të Ushqimit si dhe atyre nga FAO është realizuar monitorimi i disa lokacioneve (habitateve) me shpezët të egra migrues dhe vendore si: ligatina në Henc, liqeni i Batllavës, Badovcit dhe Radoniqit, si dhe disa nga lumenjtë kryesorë si: Drini i Bardhë, Sitnica etj. ¹⁸

17 Sherifi, Y.(2010) Ekosistemi i Ligatinës në Henc / Radevë, mundësitë e menaxhimit të qëndrueshëm të sajë, Punim Master, UP-FSHMN, Prishtine

18 Maxhuni, Q. (2009): *Some aspects of birds fauna in Kosovo*, International Wader Study Group Conference, Texel, Netherland.

8. INICIATIVAT DHE AKTIVITETET RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE

Parku Ballkanik i Paqes

Sipas IUCN, Parqet Ndërkufitare definohej si; “zona të mbrojtura ndërkufitare të cilat formalisht janë të dedikuara për mbrojtjen dhe kujdesin për shumëllojshmërinë biologjike, vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore si dhe promovimin e paqes dhe bashkëpunimit”.

Nisma për krijimin e Parkut Ndërkufitar në trekëndëshin e kufirit Kosovë - Shqipëri-Mali i Zi, ka rrjedhë nga shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare. Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve për themelimin e këtij parku duhet veçuar fuqizimin e shoqatave mjedisore të zonës tre-kufitare, i njohur si “Koalicioni i Parkut Ndërkufitar në Ballkan”.

Këto hapësira janë të kërcënuara nga depopullimi, andaj shpallja e tyre zonë e mbrojtur ndërkufitare do të ishte e mirëseardhur për popullatën lokale që përmes ekoturizmit dhe përfitimeve tjera të mbetet në këto hapësira që është edhe njëra nga qëllimet e krijimit të këtij Parku Ndërkufitar. Përveç kësaj Parku do të inkurajoj investitorët e huaj dhe njëkohësisht do të siguroi mbrojtje më të mirë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Janë zhvilluar takime të niveleve të ndryshme në tri vendet dhe është arritur përkrahje dhe pajtueshmëri si dhe ka gjetur përkrahjen e donatorëve si: GTZ, UNEP, IUCN, Agjencinë Austriake për Zhvillim, REC, KFOS etj.

Iniciativa për Brezin e Gjelbër Evropian

Zyra e programit për Evropën Jug-Lindore të IUCN-së, në bashkëpunim me partnerët lokale për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni si dhe me mbështetjen e ENVSEC (Nisma për Sigurinë dhe Mjedisin), zbatoi projektin “Bashkëpunimi civilo-ushtarak për nxitjen e ruajtjes së natyrës përgjatë “Brezit të Gjelbër Evropian” (Evropa Jug-Lindore)” në kufirin trepalësh ndërmjet Kosovës - Shqipërisë dhe Maqedonisë. Projekti u zbatuar gjatë vitit 2008 dhe u financua nga Agjencia Federale Gjermane për Mbrojtjen e Natyrës (BfN). Objektivi kryesor i këtij projekti ishte të afroje së bashku sektorët civilë dhe ata ushtarakë, duke kombinuar mbrojtjen e natyrës me sigurimin e paqes në zonën trepalëshe, e cila formon një pjesë integrale të rrjetit ekologjik të Brezit të Gjelbër Evropian¹⁹.

Nisma Evropiane e Brezit të Gjelbër ka për vizion krijimin e boshtit të një rrjeti ekologjik që shkon nga Deti Barents deri në Detin e Zi, duke përfshirë disa prej habitateve më të rëndësishme në fushën e biodiversitetit dhe thuajse të gjitha rajonet e zhdukura biogeografike të Evropës.

¹⁹ <http://www.europeangreenbelt.org/>



Fig. 38. Pjesëmarrësit e këtij projekti gjatë trajnimit në Kukës

Gjatë zbatimit të këtij projekti u mbledhën së bashku akterë të mbrojtjes së natyrës, ushtrisë e policisë kufitare dhe përfaqësues të pushtetit vendor për të diskutuar interesat e përbashkëta në ruajtjen e natyrës dhe të gjejnë rrugët e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Kjo u realizua nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve trajnuese me akterët e lartpërmendur mbi çështje ekologjike dhe social-politike të rajonit kufitar.

Aktivitetet e organizuara në kuadër të kësaj mbështetje

- Takim pune me akterët e identifikuar nga të tre vendet pjesëmarrëse në projekt dhe përfaqësues ndërkombëtarë të projektit, në Shkodër më 22-23 Shtator 2008.
- Trajnim për akterët përgjegjës për brezin kufitar në zonën e projektit në Kukës më 23-24 Tetor 2009.
- Trajnim për akterët përgjegjës për brezin kufitar në zonën e projektit në Mavrovë (Maqedoni) më 29-31 Tetor 2009.
- Trajnim për akterët përgjegjës për brezin kufitar në zonën e projektit në Prevallë (Kosovë) më 3-4 Nëntor 2009.

Si produkt i trajnimeve në kuadër të këtij projekti është edhe botimi i një materiali ekskursioni, që synon të shërbeje si mjet për të shijuar dhe mbrojtur natyrën e çmuar të rajonit, që përfaqëson një pasuri të përbashkët të popujve që jetojnë këtu. Ky botim synon t'i vijë në ndihmë policisë kufitare, personave të ngarkuar me konservimin e natyrës si dhe autoriteteve lokale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, duke u venë në dispozicion një mjet për bashkëpunim në fushën e konservimit të natyrës në rajonet ndërkufitare. Botimi synon të jetë një instrument për të shijuar dhe mbrojtur vlerat e natyrës së çmuar në zonën e përbashkët kufitare, e cila, në të njëjtën kohë bën pjesë

edhe në Brezin e Gjelbër të Evropës Juglindore, si dhe në rritjen e niveleve të ndërgjegjësimit për vlerat natyrore të rajonit në radhët e pjesëtarëve të policisë kufitare dhe akterëve të tjerë.



Rrjeti i zonave të gjelbra që përbëhet nga zona të mbrojtura do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit – pikësepari duke harmonizuar metodat e menaxhimit në të dyja anët e kufirit. Brezi i Gjelbër bashkon parqe kombëtare, parqe natyrore, rezervatet e biosferës dhe zonat e mbrojtura ndërkufitare, por edhe ato të pambrojtura, përgjatë apo përmes kufirit dhe mbështet nismat për zhvillim rajonal që bazohen në ruajtjen e natyrës.

Vetë nisma mbikëqyret nga koordinatori i IUCN për Brezin e Gjelbër. Si Sekretariat për Nismën Evropiane të Brezit të Gjelbër shërben Zyra rajonale e IUCN për Evropën në Bruksel. Si pika fokale për 23 vendet që kanë aderuar në Nismën e Brezit të Gjelbër shërbejnë autoritetet kombëtare të autorizuar nga agjencitë përkatëse shtetërore për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin rajonal.

Duke pranuar një strukturë të tillë, nisma i kushton rëndësinë e duhur faktit se Brezi i Gjelbër mund të ketë domethënie dhe peshë të ndryshme për pjesëmarrës të ndryshëm në këtë nismë.

GeoTrip-2009 “Bjeshkët e Nemuna” organizuar nga ProGEO - Albania në bashkëpunim me ProGEO - Kosovë

Bjeshkët e Nemuna, përbejnë një gjeopark madhështor Alpin me shtrirje në tre shtete: Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi. Gjeoeskursioni i vitit 2009 u realizua në prag të Takimit final të Vitit të Planetit (IYPE) e që mbahej me 20-22 Nëntor 2009 në Lisbonë të Portugalisë. E veçanta e GeoTrip 2009 është organizimi i përbashkët me anëtarët e ProGEO nga Shqipëria dhe Kosova. GeoTrip 2009 është organizuar në formën e një Projekti tre ditor në Bjeshkët e Nemuna të Alpeve Shqiptare dhe në vazhdimin me verilindor të tyre në territorin e Kosovës. Gjeoeskursioni “Geo Trip 2009” është mbështetë edhe nga Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Itinerari i GeoTrip 2009 ishte Shkodër-Koman, Bajram Curri-Valbonë, Gr. e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Burimi i Istogut, Burimi termal i Banjës, Ujëvarat e Mirushës dhe Shpella e Gadimes.



Fig 39. Pjesëmarrësit në “GeoTrip 2009” nga ProGEO-Albania dhe ProGEO-Kosova

Pjesëmarrja në kuadër të aktiviteteve të MAB- UNESCO

Prej 11-15 nëntor 2008 në Central Balkan National Park të Republikës së Bullgarisë është mbajtur Seminar ndërkombëtar për rol ruajtës lidhur me mbrojtjen e natyrës përmes MAB në Evropën Jug-lindore. Organizator ishte zyra e UNESCO - BRESCHE të Italisë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit të Bullgarisë dhe Komitetit të MAB për Bullgari. Rëndësia e veçantë e përfshirjes së Kosovës në këto takime ishte inkuadrimi i Kosovës në rrjedhat e shteteve anëtare të Evropës Jug-Lindore si dhe marrja e përvojave për përparimin e mbrojtjes së natyrës.



Shënimi i 22 Majit – Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit

Me moton “Biodiversiteti, siguri e jetës për botën tonë në ndryshim”, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në bashkëpunim me Asociacionin për Kulturë, Edukim dhe Arsim - AKEA, gjatë vitit 2009 kanë shënuar 22 majin, Ditën Botërore të Biodiversitetit.

Shënimi i kësaj dite në Kosovë kishte për qëllim sensibilizimin e opinionit që biodiversitetin të mos e konsiderojnë vetëm si vlerë për konsum dhe përdorim të drejt-përdrejtë e afatshkurtër, por ruajtjen dhe mbrojtjen e tij, ta konsiderojnë si detyrim moral, që pasardhësve t’ua lemë një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë.

Me këtë rast përveç mesazheve nga përfaqësuesit e institucioneve mjedisore qeveritare dhe joqeveritare u paraqitën edhe prezantime për rëndësinë e biodiversitetit. Po ashtu u bë shpërndarja e posterëve dhe fletëpalosjeve të përgatitura enkas për këtë aktivitet si dhe u organizua një ekspozitë me fotografi nga vlerat e biodiversitetit të Kosovës.



Fig. 41. Pamje nga shënimi i aktivitetit për ditën e Biodiversitetit

9. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

KORNIZA LIGJORE

Tabela 8. Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës që lidhen me mjedisin

Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Nr. dhe data e shpalljes
LIGJI PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT	2003/08	16.01.2003	2003/09 15.04.2003
LIGJI PËR PYJET E KOSOVËS	2003/03	13.02.2003	2003/06 20.03.2003
LIGJI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	2003/14	03.07.2003	2003/30 10.09.2003
LIGJI PËR PESTICIDET	2003/20	16.10.2003	2003/35 06.12.2003
LIGJI PËR ENERGIJË	2004/09	29.04.2004	2004/21 30.06.2004
LIGJI PËR UJËRAT	2004/24	08.07.2004	2004/41 14.10.2004
LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA	2004/30	28.07.2004	2004/48 25.11.2004
LIGJI PËR BLEGTORINË E KOSOVËS	2004/33	08.09.2004	2004/39 14.10.2004
LIGJI PËR UJITJEN E TOKËS BUJËSORE	02/L-09	23.03.2006	2006/49 25.11.2006
LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS	02/L-18	23.03.2006	2006/22 24.04.2006
LIGJI PËR TOKAT BUJËSORE	02/L-28	24.06.2006	2006/37 23.06.2006
LIGJI PËR MBETURINA	02/L-30	22.07.2006	2006/31 06.05.2006
LIGJI PËR GJETHINË	02/L-53	16.12.2006	2006/41 11.06.2006
LIGJI PËR VEPRIMTARIJË HIDROMETEOROLOGJIKE	02/L-79	15.06.2006	2007/02 09.01.2007
LIGJI PËR TRASHËGIMIN KULTURORE	02/L-88	09.10.2006	2006/52 06.11.2006
LIGJI PËR MBROJTJEN E BINJËVE	02/L-95	22.12.2006	2007/06 31.01.2007
LIGJI PËR MBROJTJEN E VARIETETEVE TË BINJËVE	02/L-98	26.01.2007	2008/24 16.05.2008
LIGJI PËR MBROJTJEN NGA ZHURIMA	02/L-102	30.03.2007	2008/15 17.03.2008
LIGJI PËR BLETARI	02/L-111	30.03.2007	2008/05 08.02.2008
LIGJI PËR KIMIKAT	02/L-115	27.04.2007	2008/08 08.02.2008
LIGJI PËR BUJËSINË ORGANIKE	02/L-122	17.09.2007	2008/02 08.01.2008
LIGJI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BINJËVE	03/L-042	07.11.2008	Dekreti nr. DL-081-2008
LIGJI PËR NDRYSHIMIN E L. PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	03/L-106	10.11.2008	Dekreti nr. DL-085-2008
LIGJI PËR UJSHQIMIN	03/L-016	12.02.2009	Dekreti nr. DL-004-2009
LIGJI PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR	03/L-015	12.02.2009	Dekreti nr. DL-003-2009
LIGJI PËR VLERËSIMIN E NOKIMIT NË MJEDIS	03/L-024	26.02.2009	Dekreti nr. DL-006-2009
LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	03/L-025	26.02.2009	Dekreti nr. DL-007-2009
LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES	03/L-043	26.03.2009	Dekreti nr. DL-010-2009
LIGJI PËR PRODUKTET BIOIDE	03/L-119	27.05.2009	Dekreti nr. DL-014-2009
LIGJI PËR BUJËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL	03/L-080	11.06.2009	Dekreti nr. DL-015-2009
LIGJI PËR GAZIN NATYROR	03/L-133	02.11.2009	Dekreti nr. DL-030-2009

Tabela 9. Projektligjet në procedurë

Emërtimi i Projektligjit	Nr. dhe data e parimit	Dt. shpërndarjes deputetëve	Shqyrtimi i parë
LIGJI PËR MBROJTJE NGA RREZATINI JOJONIZUES, JONIZUES DHE SIGURIA NUKLEARE	03/L-104 21.10.2008	22.10.2008	20.11.2008
LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/3 PËR PYJET E KOSOVËS	03/L-153 12.05.2009	19.05.2009	25.05.2009
LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA	03/L-160 12.06.2009	18.06.2009	24.07.2009
LIGJI PËR MINERAT DHE MINERALE	03/L-163 12.06.2009	17.06.2009	09.07.2009
LIGJI PËR TURIZMIN DHE SHËRBIMET TURISTIKE	03/L-168 20.08.2009	26.08.2009	17.09.2009

Udhëzimet Administrative

Aktet e tjera Nënligjore të rëndësishme janë:

- Udhëzimi Administrativ: Për Formën dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit Qendror të Zonave të Mbrojtura të Natyrës (Nr.04/2006-MMPH, shtator 2006)
- Udhëzimi Administrativ: Për Mënyrën e Shënimit të Zonave të Mbrojtura të Natyrës (Nr.01/07-MMPH , dhjetor 2006)
- Udhëzimi Administrativ: Për Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të Natyrës. (Nr 11/07 –MMPH, nëntor 2007)
- Udhëzimi Administrativ: Për Kriteret dhe Procedurat për Shfrytëzimin e Shpellave
- Udhëzimi Administrativ: Për Dhënien e Lejes Ekologjike (Nr.26/05-MMPH, nëntor 2005)
- Udhëzimi Administrativ: Për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe Masat e tyre të Mbrojtjes për Burimet e Ujit që Përdoren për Pije (Nr.13/07-MMPH)
- Udhëzimi Administrativ: Për Zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi Elementet Themelore të Përmbytjes së Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta (Nr.2005/42-MMPH, mars 2005)
- Vendimet për Zonat e Mbrojtura

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është në përgatitje e sipër edhe të disa projektligjeve shumë të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës siç janë :

- Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës,
- Projektligji për Parkun Kombëtar “Mali Sharr”,
- Projektligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mjedisin

Në qershor të vitit 2004, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Strategjinë e Kosovës për Mjedis, ndërsa në mbështetje të këtij dokumenti dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit gjatë vitit 2006 është hartuar edhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006 - 2010.

Objektivë kryesorë e këtij plani sa i përket mbrojtjes së natyrës ishte: “ Krijimi i një sistemi më efikas ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore, si dhe futja nën mbrojtje të 10% e territorit të Kosovës”.

Për arritjen e kësaj objektivë edhe pse janë përgatitë disa projekte asnjëra nga këto deri më sot nuk ka filluar të realizohet.

Po ashtu gjatë vitit 2009 ka filluar përgatitja e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2010 – 2020.

INSTITUCIONET PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Kuvendi i Kosovës

Organi më i lartë ligjvënës në Kosovë i përbërë nga 120 deputet. Në kuadër të Kuvendit vepron Komisioni funksional për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i cili në vitin 2005 fuzionohet me komisionin për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural me 15 anëtarë. Kuvendi miraton Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, shpallë Parqet Kombëtare, miraton Strategjinë e Mbrojtjes së Natyrës etj

Qeveria e Kosovës e përbërë nga 18 ministri në kuadër të të cilës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ndër të tjera është përgjegjëse që “të krijojë politikatat, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën, bioiversitetin”. Në kuadër të MMPH-së është edhe Drejtoria e Parkut Kombëtar “Mali Sharr”, e cila merret me menaxhimin e territorit të Parkut Kombëtar. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij e bën Ministria përmes inspektorit të mbrojtjes së natyrës në kuadër të Inspektoratit Mjedisor.

Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës

AMMK-ja është themeluar pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit²⁰ nga Kuvendi i Kosovës. Në kuadër të Agjencisë përfshihen: Instituti i Mbrojtjes së Natyrës së Kosovës (IMNK) dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK). Detyrat e Agjencisë janë monitorimi i mjedisit, informimi i publikut dhe institucioneve vendore, por edhe ndërkombëtare për gjendjen e mjedisit në Kosovë, si dhe projekte kërkimore e shkencore nga fusha e mjedisit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Është themeluar në vitin 1974 me emrin Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës²¹, Instituti i kryen punët profesionale për mbrojtjen e natyrës në kuadër të AMMK-së siç janë:

- Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës;
- Hartimi i bazave të caktuara për llojet e bimëve, shtazëve, kërpudhave, habitateve, ekosistemeve dhe peizazheve;
- Monitorimi i gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozimi i masave për mbrojtjen e natyrës’

20 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9

21 Neni 9.2. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.2006/22

- Kryerja e analizave statistikore, përmbledhja e rezultateve dhe hartimi i raporteve për gjendjen e mbrojtjes së natyrës;
- Zbatimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

Faktikisht ky Institut nuk funksionon, por mbrojtja e natyrës realizohet përmes një sektori në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, harton politikat për bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkatarinë, etj

Agjencioni Pyjor i Kosovës

APK-ja është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike dhe pyjeve në Parqet Kombëtare në Kosovë, përveç atyre çështjeve që ligji në mënyrë të veçantë i cakton ndonjë autoriteti tjetër të Qeverisë.

Muzeu i Kosovës - Seksioni i natyrës në kuadër të saj ruan trashëgiminë natyrore të Kosovës.

Kuvendet Komunale, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë dhe Planin e Veprimit dhe dokumentet për planifikim hapësinor detyrohen²² që: të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore në territorin e vet, të shpallin zonat e mbrojtura që janë kompetencë e tyre, të sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre, të marrin pjesë në hartimin e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre, të informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e tyre dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj, etj.

Institucionet Shkencore

Akademia e Shkencave të Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës, merren me kërkime dhe hulumtime shkencore në lëmin e natyrës dhe biodiversitetit.

Organizatrat e Shoqërisë Civile Mjedisore

Sipas vlerësimeve të fundit të bëra në vitin 2006, del se në Kosovë janë të regjistruara 30 OJQ mjedisore aktive. Këto OJQ sa i përket shtrirjes vijnë nga 15 komuna të Kosovës, ndërsa më së shumti janë aktive në Prishtinë. Sipas këtij vlerësimi në gjysmën e Komunave të Kosovës nuk ka fare OJQ- mjedisore të regjistruara. Edhe përkundër numrit të konsideruar të OJQ mjedisore gati asnjë prej tyre nuk e ka programin e vet të orientuar vetëm për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

22 Neni 10 i LMN 2006/22

10. PROBLEMET DHE REKOMANDIMET

Problemet:

- Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- Transpozimi jo i kënaqshëm i Direktivave të Shpendëve dhe Habitave në Ligjin e Natyrës;
- Mungesa e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Natyrën dhe Biodiversitetin;
- Mungesa e një Institucioni që merret ekskluzivisht me mbrojtjen e natyrës (Instituti për Mbrojtjen e Natyrës);
- Mungesa e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Mungesa e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Shfrytëzim i pa pakontrolluar i resurseve natyrore në zonat e mbrojtura;
- Mungesa e hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet;
- Buxheti i pamjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e kuadrove të mjaftueshme për mbrojtjen e natyrës.

Rekomandimet:

- Aprovimi i 3 Ligjeve të reja: Për Mbrojtjen e Natyrës, për Parkun Kombëtar “Mali Sharr” dhe për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;
- Përkrahja e projekteve hulumtuese për inventarizimin e llojeve dhe habitave, shpellave etj.
- Hartimi i Listës së Kuqe të florës dhe faunës;
- Përkrahja e projekteve ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës;
- Përgatitja e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin për mbrojtjen e natyrës
- Themelimi i zyrës koordinuese për identifikimin, ratifikimin dhe implementimin e konventave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

I I. REFERENCAT

1. Arkivi i IKMN-së (2004): Raportet, dokumentet dhe aktvendimet për zonat e mbrojtura,
2. Bajraktari, F. (2009): *Trashëgimia e natyrore në pellgun e lumit Mirusha*, (Punim Masteri), Prishtinë,
3. Bajraktari, F., Sherifi, Y., Berisha, A., Behrami, S., Maxhuni, Q. (2010): *Protected and proposed for protection hydric monuments in Kosovo 2002-2008*, The Fourth International Scientific Conference BALWOIS 2010, Ohrid, Republic of Macedonia
4. Behrami, S., Bajraktari, F., Maxhuni, Q., Abazi, Sh., Zogaj, N. (2007): *Inventory and protection of geo – monuments in Kosovo*, The 12 th Regional Conference on Geoconservation and ProGEO Working Group I Annual Meeting, Ljubljana, Slovenia, 5-9 September
5. Berisha, A., Bajraktari, F., Sherifi, Y., Hajdari, R. (2009): *Zonat e mbrojtura të natyrës dhe zonat e propozuara për mbrojtje në Kosovë në periudhën 2000 - 2008*, “Alb shkenca”, Tetovë.
6. EKMN (1975): *Natyra e Kosovës, publikim për Beshkët e Nemuna*, Enti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, Prishtinë.
7. EKMN (1982): *Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për Park Kombëtar*, Prishtinë,
8. EKMN (1985): *Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së një pjese të Beshkëve të Nemuna Park Kombëtar*, Prishtinë.
9. Bajraktari, F. & Maxhuni, Q. (2007): *Caves - value and their protection in Kosova*, 13th International Cave Bear Symposium 20-24 September, Brno, Czech Republic
10. Gashi, A. (2006): *Analiza biocenologjike dhe ekologjike e makrozoobentosit dhe nektonit të lumit Llap*, disertacion i doktoraturës, UP - FSHMN, Prishtinë
11. Grapci – Kotori, L. (2006): *Ndikimi i faktorëve ekologjik në dinamikën e popullatave të llojeve të peshqve në lumin Drini i Bardhë*, disertacion i doktoraturës, UP - FSHMN, Prishtinë
12. <http://www.aragonit-speleo.org/>
13. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Malishevës*
14. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Gjakovës*,
15. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Skenderajt*
16. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Gjilanit*;
17. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Rahovecit*,

18. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Klinës,*
19. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Drenasit,*
20. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Istogut,*
21. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Podujevës*
22. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Mitrovicës*
23. IKMN (2005) *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vitisë*
24. IKMN (2005): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Obiliqit*
25. IKMN (2005): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vushtrrisë,*
26. IKMN (2005): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Istogut,*
27. IKMN (2005): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Drenasit,*
28. IKMN (2005): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Malishevës,*
29. IKMN (2005): *Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës,*
30. IKMN (2006) *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Lipjanit,*
31. IKMN (2006): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Fushë Kosovës*
32. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Podujevës,*
33. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Obiliqit,*
34. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Klinës ,*
35. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Skenderajt,*
36. IKMN (2007): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Shtimes*
37. Krasniqi, E., Berisha, A., Mala, Xh., Maxhuni, Q., Bajraktari, F., Hajdari, R., Hoti, H. (2007): *Stenoendemic species of Kosova's flora*, 31st International Symposium on Vegetation in SE Europe, 04-06 July 2007 Prishtina, Kosova
38. Ligji për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut ("GZK" 39/88)

39. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (2005/02-LI8) Rreg. nr. 2006/22 të datës 24.04.2006
40. Ligji për Parkun Kombëtar “Mali Sharr” GZK. I I/86, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë,
41. Ligji për Themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës (“GZK”. I5/81)
42. Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit (“GZK”nr. 38/89)
43. Maxhuni, Q. (2009): *Some aspects of birds fauna in Kosovo*, International Wader Study Group Conference, 18 – 21 September 2009, Texel, Netherland
44. Maxhuni, Q. (2009): *Uticaj ekoloških faktora na dinamiku populacija riba rijeke Drenice*, magistarski rad, US – PMF, Sarajevo
45. Millaku, F. (1999): *Flora subalpike dhe alpine e Alpeve Shqiptare (Kosovë)*, disertacion i doktoratures UP- FSHMN, Prishtinë
46. MTI. *Regjioni turistik i Bjeshkëve të Nemuna*, 2007, Prishtinë, Broshurë
47. Pllana, R. Gashi, G., Bajraktari, F., Behrami, S. (2006): *Hidrologig Heritage in the System of Natural Values and its Protection in Kosova*, Balwois, Ohër
48. Pllana, R., Pruthi, V. (2003): *Raporti për shpella ne Kosovë*, MMPH, Prishtinë
49. Pruthi, V., Restelica, S., Hajra, H., Bajraktari, F.(2005): *Shpella e Gadimes - Monument i veçantë*, 22-28, Maj, Sarajevë, Bosnje.
50. Rexhepi, F. (1986): *Flora e Maleve të larta të Kosovës*, ETMMK, Prishtinë.
51. Rexhepi, F. (1994): *Vegjetacioni i Kosovës (I)*, UP, FSHMN, Prishtinë.
52. Sherifi, Y. (2010) *Ekosistemi i Ligatinës në Henc / Radevë*, mundësitë e menaxhimit të qëndrueshëm të sajë, Punim Master, UP-FSHMN, Prishtinë
53. Sherifi, Y., Mustafa, B. (2002): *Disa veçori të faunës së Malit Sharr*, Studime Gjeografike, Nr. 14. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë,
54. Sherifi, Y., Mustafa, B. (2004): *Vështrim i shkurtër i faunës së Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Lindore shqiptare)*, Studime Gjeografike, Nr. 15. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë
55. Shoqata e Ekologëve të Kosovës (2002): *Biodiversiteti i Gjermisë, vlerat dhe rreziqet që e kërcënojnë*, publikim, Prishtinë
56. Vendimi për ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyrës (“GZK”. 42/74)
57. Veselaj, Z., Mustafa, B., Hajdari, A., Sherifi, Y. (2008): *Disa aspekte të kërcënimit të biodiversitetit në rezervatet strikte të natyrës në Kosovë*, Instituti Albshkenca Tiranë,
58. Veselaj, Z., Sherifi, Y. (2001): *Llojet e rralla bimore dhe shtazore të Kosovës*, Publikim Ekoklina & IMNMK, Prishtinë.

**GJENDJA E NATYRËS
RAPORT
2008 - 2009**

Botues:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës

Raportin e përgatitën:

MSc. Ylber Sherifi, *udhëheqës i sektorit për mbrojtjen e natyrës*
MSc. Fadil Bajraktari, *zyrtar për zona të mbrojtura*
Mr. sc. Qenan Maxhuni, *zyrtar për biodiversitet*

Lektor:

Tone Buzhala - Gashi

Dizajni:

Ylber Sherifi
Arianit Dërguti

Ballina dhe faqja e fundit:

Foto nga faqja e parë: Bekim Bytyqi (peizazh nga Sharri)
Foto nga faqja e fundit: Nexhmedin Ramadani (peizazh nga Sharri)

U shtyp në shtypshkronjën:
IN Design

® Ndalohej shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar

Prishtinë, 2010

